

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Mars 2022/ Nr. 3

RUSIA SULMON UKRAINËN

Ministri Peleshi: Jemi më shumë se kurrë të bashkuar në NATO në këtë luftë vlerash



Përmbajtja

Numri 3

Prokurimet në FA

- 8** Ministri i Mbrojtjes:
Reformojmë tërësisht praktikën
e prokurimeve në FA

BASHKËPUNIMI

- 9** Ministri Peleshi:
Roli i KFOR-it i
pazëvendësueshëm

AMBASADORI I KOSOVËS NË TIRANË

- 10** Gjeneralmajor Begaj: Bashkëpunim
ushtarak i shkëlqyer mes dy vendeve në
fushën e mbrojtjes

ANALIZA

- 29** Konflikti në Ukrainë, drejt
"racionalitetit" apo "çmendurisë"?

JENS STOLTENBERG

- 36** "Nuk ka vend për llogaritje të gabuara
në lidhje me aftësinë tonë për të
mbrojtur të gjithë aleatët"

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 **RUSIA SULMON UKRAINËN**

Ministri Peleshi: Jemi më shumë se kurrë të bashkuar në NATO në këtë luftë vlerash

E dënojmë me forcë sulmin e pa justifikuar dhe të paramenduar të Federatës Ruse ndaj sovranitetit dhe popullit ukrainas. Një akt i paprecedent në historinë moderne, që dhunon...



6 **TAKIMI**

Ministri Peleshi: Shqipëria e gatshme të shtojë kontributin në kufijtë juglindorë të Aleancës

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi mori pjesë në takimin dyditor të ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës, i cili u zhvillua në selinë e NATO...



16 **INTERVISTA**

Gjeneral brigade Ylli Pulaj: Të rinjtë shqiptarë duhet ta shikojnë me prioritet pjesëmarrjen në FA, veçanërisht në radhët e Forcave Ajrore

I nderuar z. Gjeneral Brigade Ylli Pulaj, ju urojmë suksese në rrugëtimin tuaj drejt sfidave që ka Forca Ajrore, të cilën ju drejtoni! Për lexuesit tanë do...



20 **10-VJETORI I RËNIES NË KRYE TË DETYRËS SË FETI VOGLIT**

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Sakrifica dhe gjaku i një akti të tillë nuk mund të harrohen

Në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore (FT), u zhvillua ceremonia përkujtimore me rastin e 10 - vjetorit të rënies në krye të detyrës...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 3/ 2022

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”


Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>





Edënojmë me forcë sulmin e pa justifikuar dhe të paramenduar të Federatës Ruse ndaj sovranitetit dhe popullit ukrainas. Një akt i pa-precedent në historinë moderne, që dhunon rendin botëror, çdo marrëveshje dhe ligj ndërkombëtar, dhe gjithashtu rrezikon seriozisht paqen dhe sigurinë e zonës Euro-Atlantike. Jemi më shumë se kurrë të bashkuar në NATO në këtë luftë vlerash, duke ndenjur vigjilent dhe ndjekur çdo implikim apo sfidë të mundshme në rajonin tonë.



RUSIA SULMON UKRAINËN

Ministri Peleshi: Jemi më shumë se kurrë të bashkuar në NATO në këtë luftë vlerash





16-17 shkurt 2022 / Takimi dyditor i ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës

Ministri Peleshi: Shqipëria e gatshme të shtojë kontributin në kufijtë juglindorë të Aleancës

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi mori pjesë në takimin dyditor të ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës, i cili u zhvillua në selinë e NATO-s në Bruksel.

Ndonëse kriza aktuale e shkaktuar nga dislokimi i forcave të mëdha ushtarake ruse në kufijtë e Ukrainës ka tërhequr vëmendjen e audiencës në mbarë botën dhe përbën një moment mjaft

kulmor që pas Luftës së Ftohtë, në axhendën e këtij takimi do të diskutohen edhe çështje të tjera mjaft të rëndësishme si: Koncepti i ri Strategjik; Forcimi i parandalimit dhe mbrojtjes së Ale-



Ministeriali i Mbrojtjes së NATO-s, Peleshi: Jemi në rrugën e duhur për të rritur në 2% të PBB shpenzimet për Mbrojtjen

ancës; Shpenzimet e Mbrojtjes; Ndarja e drejtë e barrës ndërmjet Aleatëve; Partneriteti NATO - BE; etj. Ministri i Mbrojtjes z. Peleshi, në fjalën e tij theksoi qëndrimin e unifikuar të Shq-

ipërisë me vendet e tjera Aleate se çdo vend është i lirë dhe ka të drejtën sovrane për të zgjedhur rrugën e vet në aleancat e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe orientimin e politikës së jashtme.

Gjithashtu, ai përmendi rolin e Shqipërisë si bashkëpenëmbajtëse me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi çështjen e Ukrainës.

Më tej, ministri Peleshi theksoi rëndësinë e ruajtjes së solidaritetit dhe kohezionit që Aleanca duhet të tregojë gjithmonë, por veçanërisht në këtë moment. Ai nuk la pa përmendur dhe vlerësuar rolin e pazëvendësueshëm të Komandave Strategjike dhe strukturave të tjera të NATO-s, në mobilizimin dhe gatishmërinë e përhershme në ruajtje të kufijve të vendeve të Aleancës.

Për këtë, ministri Peleshi solli në vëmendje kontributet aktuale të vendit tonë në kuadër të Aleancës, si dhe vendimet më të fundit për mundësinë e shtimit të kontributit në kufijtë juglindorë të Aleancës, sipas modelit të Prezencës së Përfortuar të Përparuar në vendet Baltike (eFP). Për sa i përket zhvillimit dhe implementimit të kapaciteteve të Mbrojtjes, z. Peleshi rikonfirmoi edhe njëherë angazhimin e Shqipërisë për përbushjen e Zotimit për Investime në Mbrojtje që vendet anëtare morën në Samitin e Uellsit në 2014, për arritjen e buxhetit të Mbrojtjes deri në vitin 2024 në jo më pak se 2% të PBB. Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi i kushtoi vëmendje të veçantë edhe hartimit të Konceptit të ri Strategjik të NATO-s, duke vlerësuar kohën që ai vjen, si mjaft të duhur dhe të rëndësishme, për faktin që situata e sigurisë dhe rreziqet në mbarë globin po zhvillohen në mënyrë mjaft të paparashikueshme dhe kaotike.

Në këtë kuadër, zoti Peleshi kërkoi që rajonit të Ballkanit t'i kushtohet vëmendja e duhur në hartimin e Konceptit të ri Strategjik të NATO-s

Prokurimet më domethënëse të FA do të kryhen nga Agjencia e NATO-s

Ministri Peleshi: Reformojmë tërësisht praktikën e prokurimeve në FA

Prokurimet më domethënëse të Forcave të Armatosura shqiptare për mjete, pajisje, armatim dhe shërbime do të kryhen nga Agjencia e NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimet (NSPA). Prokurimet nëpërmjet NSPA do të garantojnë, jo vetëm ekspertizë më të madhe në hartimin dhe zbatimin e kontratave, por edhe çmime më të mira, duke qenë se kjo agjenci ka një fluks shumë herë më të lartë në marrjen e shërbimeve dhe blerjen e pajisjeve nga operatorët më të mëdhenj globalë që operojnë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi zhvilloi një vizitë në selinë e kësaj agjencie në Luksemburg, ku u prit nga menaxherja e Përgjithshme, znj. Stacy Cummings. Pasi i uroi mirëseardhjen, znj. Cummings dhe stafi i saj e njohën ministrin Peleshi dhe delegacionin me disa prej detyrave dhe përgjegjësi kryesore të NSPA. Ajo vlerësoi bashkëpunimin e frytshëm që NSPA ka me Shqipërinë dhe që kulmon me projektin e Bazës Ajrore Kuçovë. Nga ana e tij, ministri Peleshi falënderoi znj. Cummings për mikpritjen dhe e përgëzoi atë për liderhipin e treguar në drejtimin e kësaj agjencie, të cilën ai e konsideroi si jetike për suksesin e NATO-s në operacione



dhe misione, me mbështetjen dhe shërbimet që ofron për Aleancën dhe vendet partnere. Në këtë kontekst, ai veçoi projektin e transformimit dhe modernizimit të bazës ajrore të Kuçovës, ku NSPA luan një rol tepër të rëndësishëm. Bazuar edhe në suksesin e këtij projekti, ministri Peleshi diskutoi me znj. Cummings mbi mundësi të reja bashkëpunimi me NSPA, ku ndër më kryesoret përmendi vijimin e bashkëpunimit për mirëmbajtjen e helikopterëve të flotës ajrore të FARSH; mundësi mbështetje për sistemin e Emergjencave Civile të vendit tonë; realizimin e projektit

për kompletimin e FARSH me spital fushor Role-2, si dhe sigurimin e transportit strategjik për efektivë të FARSH të angazhuar në misione dhe operacione të ndryshme.

Në përfundim të këtij takimi, ministri Peleshi e siguroi znj. Cummings se bashkëpunimi i shkëlqyer që vendi ynë ka me NSPA, do të vijim pasi, ekspertiza e stafit të kësaj agjencie dhe fusha e gjerë e shërbimeve që ajo ofron, do të kontribuojnë në rritjen e operacionalitetit dhe gatishmërisë së strukturave të ndryshme të Forcave tona të Armatosura.

Ministri Peleshi pret komandantin e KFOR-it

Ministri Peleshi: Roli i KFOR-it i pazëvendësueshëm

“Shtojmë kontributin e Forcave të Armatosura shqiptare në këtë mision”

Forcet e Armatosura shqiptare do të shtojnë më tej kontributin me trupa në misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR. Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi priti në një takim kortezie komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ferenc Kajári, në kuadër të vizitës së këtij të fundit në vendin tonë.

Pasi i uroi mirëseardhjen, ministri Peleshi falënderoi gjeneralmajor Kajarin për lidhshpirtin e treguar në këtë mision kaq të rëndësishëm, jo vetëm për Kosovën, por edhe gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ai vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm që KFOR ka në krijimin e mbajtjen e një ambienti të sigurt, si dhe për lirinë e lëvizjes në të gjithë territorin e Kosovës, por edhe më gjerë në rajon.

Më tej, të dy bashkëbiseduesit ndanë mendime mbi situatën aktuale të sigurisë në kufijtë lindorë të Aleancës dhe impaktin që këto zhvillime mund të kenë

në rajonin tonë. Për këtë, zoti Peleshi kërkoi vëmendje të shtuar të KFOR-it, në mënyrë që t'i paraprijë situatave që mund të lindin si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve.

Gjithashtu, ministri Peleshi e informoi komandantin e KFOR-it mbi vendimin e autoriteteve të vendit tonë për shtimin e kontributit të FARSH në këtë mision, duke dëshmuar edhe një herë rëndësinë që ka ky mision për Shqipërinë.

Nga ana e tij, gjeneral Kajári vlerësoi maksimalisht trupat shqiptare që shërbejnë aktualisht në KFOR, duke vënë në dukje nivelin e lartë të profesionalizmit të tyre, si dhe mirëpriti vendimin e vendit tonë për shtimin e kontributit në këtë mision. Më tej, ai e falënderoi ministrin Peleshi për mbështetjen e vazhdueshme që vendi ynë i jep misionit KFOR dhe e siguroi se profesionalizmi dhe dedikimi i të gjithë trupave nën komandën e tij, do të vijojë të jetë në nivelet më të larta.



Gjeneralmajor Begaj: Bashkëpunim ushtarak i shkëlqyer mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj priti në një takim ambasadorin e Republikës së Kosovës, Sh. T. z. Skënder Durmishi, ku u diskutuan marrëdhëniet midis dy vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Gjeneralmajor Begaj, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak të shkëlqyer midis dy vendeve në fushën mbrojtjes, duke nënvizuar rolin aktiv të Ambasadës së Republikës së Kosovës në promovimin e vlerave kombëtare që të dy vendet ndajnë në sigurinë e rajonit dhe më gjerë. Gjithashtu gjeneral Begaj shprehu gatishmërinë e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për implementimin e planit të bashkëpunimit me fokus shkëmbimin e eksperiencës në fushat e trajnimit, stërvitjes dhe



aktiviteteve të përbashkëta ushtarake.

Nga ana e tij, z. Durmishi vlerësoi rolin dhe asistencën e vazhdueshme të FARSH në përpjekjet për rritjen e aftësive operacionale

të FSK-së, duke theksuar se bashkëpunimi ushtarak do të vijojë të intensifikohet për të eksploruar mundësitë e ofruara në adresimin e sfidave të ndryshme brenda dhe jashtë rajonit.

BASHKËPUNIMI

Mjekët ushtarakë në ndihmë të komunitetit të zonave malore

Mjekët specialistë të Njesisë Mjekësore Ushtarake kryen vizita mjekësore për banorët e fshatrave të thellë të Bashkisë Maliq.

Mjekët ushtarakë ishin në fshatin Strelcë të njesisë administrative Gorë në bashkinë e Maliqit, ku kryen vizita mjekësore kryesisht për banorët e moshuar të këtij fshati. Mjekët në uniformë ndaluan në Strelcë pasi nuk ka shërbim mjeku dhe fshati ndodhet larg qytetit të Maliqit dhe Korçës.

Kryesisht u kryen vizita patologjike, kardiologjike si dhe u kryen teste EKG me pajisjet



portative të sjella posaçërisht nga bluzat e bardha të Forcave të Armatosura. Banorët e Strelcës i falënderuan mjekët për këtë shërbim.

Kjo nuk është hera e parë që mjekët

ushtarakë kryejnë vizita nëpër fshatra të thellë dhe do të vijojnë të jenë pranë banorëve të këtyre zonave të thella, kudo dhe kurdo ku ky shërbim kërkohet nga autoritetet vendore.

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj priti komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ferenc Kajári

“Mirënjohje ndaj burrave dhe grave nën uniformë që shërbejnë në KFOR, ku edhe Shqipëria është pjesë e këtij misioni”

Gjeneralmajor Begaj shprehu bindjen se me eksperiencën e tij në misionet dhe operacionet e NATO-s, dhe misionet e BE-së, gjeneralmajor Kajári do të jetë një vlerë e shtuar në drejtimin e KFOR-it. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj shprehu mirënjohjen ndaj burrave dhe grave nën uniformë që shërbejnë në KFOR, ku edhe Shqipëria është pjesë e këtij misioni.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj priti në një takim zyrtar komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ferenc Kajári. Vizita e komandantit të KFOR-it u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit që KFOR ka me FARSH dhe i shërben mbarëvajtjes së misionit të KFOR-it si aktor i rëndësishëm në garantimin e paqes dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet KFOR-it dhe FARSH-së.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, fillimisht e uroi dhe falënderoi gjeneralmajor Kajarin dhe shtetin e Hungarisë për marrjen e drejtimit të KFOR-it, si arritje e rëndësishme e Forcave të Armatosura të Hungarisë në kuadër të NATO-s, dhe personalisht i uroi gjeneralmajor Kajarit suksese në këtë detyrë të rëndësishme. Gjeneralmajor Begaj shprehu bindjen se me eksperiencën e tij në misionet dhe operacionet e NATO-s, dhe misionet e BE-së, gjeneralmajor Ka-

jári do të jetë një vlerë e shtuar në drejtimin e KFOR-it. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj shprehu mirënjohjen ndaj burrave dhe grave nën uniformë që shërbejnë në KFOR, ku edhe Shqipëria është pjesë e këtij misioni. Nga ana e tij, gjeneralmajor Kajari, pasi falënderoi gjeneralmajor Begaj për mikpritjen, vlerësoi kontributin e Shqipërisë në misionin e KFOR-it, ku ushtarakët shqiptarë kanë treguar dhe tregojnë një performancë të lartë. “Vlerësoj rolin e Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të RSH-së, si një partner shumë i besueshëm si dhe mbështetjen që ata i kanë dhënë dhe japin misionit tonë në realizimin e detyrave të saj”. Të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtat vlerësime dhe qasje mbi sfidat aktuale të sigurisë me të cilat përballet Kosova por edhe rajoni. Ata vlerësuan rolin e KFOR-it si një ndër aktorët kyç në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Takimi u mbyll me nënshkrimin e librit të përshtypjeve dhe shkëmbimin e dhuratave.



Kundëradmiral Agastra: Mbështetja me kurse dhe trajnime të vazhdueshme për efektivet tanë në Turqi, një element shumë i rëndësishëm për FD

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adanand Agastra dhe shefi i shtabit të Forcës Detare kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj pritën në një takim atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë në vendin tonë, kolonelin Muhammet Kelami Kablay.

Pas urimit të mirëseardhjes, kundëradmiral Agastra vlerësoi nivelin e bashkëpunimit të gjatë me Forcat e Armatosura turke në përgjithësi por në veçanti me Forcën Detare. Ai shtoi se mbështetja me kurse dhe trajnime të vazhdueshme për efektivet tanë në Turqi, ka qenë një element shumë i rëndësishëm për sa i përket arsimimit të personelit të Forcës Detare.



Nga ana e tij koloneli Kablay, falënderoi komandantin e Forcës Detare për mikpritjen dhe shprehu gatishmërinë e tij personale dhe të

Forcave të Armatosura të Turqisë për të vazhduar dhe shtuar bashkëpunimin në çdo fushë që të dy palët e shohin me interes të përbashkët.

Zëvendës ambasadorja dhe atasheu ushtarak grek zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare

Agastra: Falënderues për ndihmën dhe bashkëpunimin e deritanishëm të FA greke për realizimin e misionit në det dhe përmbushjen e angazhimeve e standardeve të NATO-s

Komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnan Agastra, paraditen e sotme priti në një vizitë kortezie zëvendës ambasadorën e Republikës së Greqisë në vendin tonë, znj. Stavroula Pentarvani si edhe atasheun ushtarak, kolonel Efthymios Ntallas.

Mbasi u uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare, kundëradmiral Agastra i falënderoi për ndihmën dhe bashkëpunimin e deritanishëm të Forcave të Armatosura greke për Forcat tona të Armatosura, njëkohësisht i njohu ata me punën dhe përpjekjet që ka bërë efektivi i Forcës Detare për realizimin e misionit në det dhe përmbushjen e angazhimeve e



standardeve të NATO-s Nga ana e saj, zëvendës ambasadorja znj. Pentarvani falënderoi komandantin e Forcës Detare për ftesën dhe mikpritjen në mjediset e Forcës Detare si dhe shprehu mundësinë

për rritjen e bashkëpunimit të zbatimit të ligjshmërisë në det midis dy vendeve. Atasheu ushtarak grek kolonel Ntallas në fjalën e tij diskutoi mbi planet e bashkëpunimit dypalësh për vitin 2022.

Komandanti i Forcës Tokësore pret në takim komandantin e KFOR-it

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji priti në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ferenc Kajári. Në bisedën e zhvilluar mes dy ushtarakëve madhorë, u nënvizua niveli i bashkëpunimit që ekziston mes KFOR-it dhe Forcave të Armatosura të RSH-së në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Gjeneralmajor Kajári vlerësoi ndër të tjera me nota pozitive edhe kontributin e ushtarakëve shqiptarë, që kanë shërbyer dhe shërbejnë në KFOR. Ndërkohë, nga ana e tij gjeneral brigade Kingji, duke e vlerësuar vizitën e komandantit të KFOR-it në Forcën Tokësore, si tregues i një niveli të



lartë vlerësimi dhe bashkëpunimi, e vuri theksin tek puna e mirë dhe profesionale që po bëhet nga

KFOR-i në Kosovë, për rritjen e stabilitetit dhe të paqes në rajon dhe më gjerë.

BASHKEPUNIMI

Forca Tokësore zhvillon aktivitete me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Sporteve Ushtarake

Në kuadër të 74-Vjetorit të Krijimit të Këshillit Ndërkombëtar të Sporteve Ushtarake (CISM), në Forcën Tokësore u organizuan një sërë aktivitete sportive. Garat sportive si kros, futboll, volejbol, pingpong, tërheqje litari etj., u zhvilluan në të gjitha repartet e FT-së, me një numër të lartë pjesëmarrësish femra dhe meshkuj.

Shpirti i garës, por mbi të gjitha i respektit reciprok dhe solidaritetit, dominoi gjatë gjithë zhvillimit të këtij aktiviteti sportiv. Përgatitja e lartë fizike, që zotërojnë efektivet e Forcës Tokësore, u shpalos edhe një herë më së miri në të gjitha garat e zhvilluara.




Presidenti Meta pret në takim ministrin e Mbrojtjes, Niko Peleshi dhe shefin e SHSHP të FA gjeneralmajor Bajram Begaj

Presidenti Republikës, SH.T. z. Ilir Meta u takua me ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Gjatë takimit u nda shqetësimi i përbashkët me të gjithë partnerët tanë të NATO-s për kërcënimin e një agresioni të mundshëm rus ndaj Ukrainës, që do të ishte një shkelje flagrante e të drejtës ndërkombëtare.

Presidenti Meta nënvizoi rëndësinë e koordinimit sa më të efektshëm me Aleancën, si dhe marrjen e masave për vijimin e



reformave në funksion të forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve tona mbrojtëse. Në këtë kontekst, u vlerësua edhe plotësimi

dhe fuqizimi i gjithë zinxhirit komandues në Forcat e Armatosura, në përputhje me sistemin gradë-funksion.

NDIHMAT

Rreth 300 pako ushqimore dërgohen për fshatrat e thellë të Burrelit dhe Peshkopisë

Rreth 300 pako kryesisht me ushqime dhe detergjentë u shpërndanë nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, nëpërmjet mjeteve të transportit të Forcave të Armatosura në bashkitë Mat dhe Dibër. Pakot ushqimore u siguruan nga Rezervat Materiale të Shtetit pas kërkesës së bërë nga kryetarët e këtyre bashkive.

Pakot në këto zona të thella u dërguan në ndihmë të familjeve në nevojë, ato me probleme sociale, shëndetësore apo të moshuar që jetojnë vetëm dhe që kanë hasur vështirësi të theksuara nga moti i ashpër dhe temperaturat e ulëta.

Në bashkinë Mat u transportuan 150 pako ushqimore dhe detergjentë, të cilat sipas planit të hartuar nga vetë administratorët lokalë u shpërndanë



në fshatrat më të thellë të një-sive administrative Derjan, Macukull, Lis, Koms, Baz dhe Ulëz. Nga ana tjetër mjeteve të transportit dhe efektive të batalionit të mbështetjes rajonale transportuan 145 pako në bashkinë Dibër, të cilat iu shpërndanë banorëve më në nevojë të fshatrave të një-sive administrative Lurë, Selishtë,

Zall-Dardhë, Reç dhe Kala e Dodës.

Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile janë në komunikim të vazhdueshëm me bashkitë dhe prefekturat, në territorin e të cilave shkaktohen probleme nga bora dhe temperaturat e ulëta dhe janë të gatshme në çdo moment të ofrojnë ndihmën e tyre.

Gjeneral brigade Kingji: Konferenca, momenti i duhur për të ofruar të gjitha kapacitetet intelektuale dhe profesionale

Në ambientet e Forcës Tokësore, u zhvillua konferenca e parë planëzuese e stërvitjes "Biza-22".

Fillimi i këtij aktiviteti, u ndoq nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Pjesëmarrës të tjerë në konferencë ishin edhe drejtori i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, përfaqësues nga Komandat kryesore dhe repartet autonome të FA.

Gjeneral brigade Kingji, përshëndeti fillimin e konferencës duke e vlerësuar atë si një nga aktivitetet më të rëndësishme, që ka për këtë vit Komanda e Forcës e Tokësore dhe repartet e saj vartëse: "Konferenca, është momenti i duhur për të ofruar të gjitha kapacitetet intelektuale dhe profesionale. Puna në grup dhe produkti që do të dalë nëpërmjet takimeve në sindikata, diskutimeve, ofrimit të njohurive nga ekspertët e fushave specifike, do e përgatisin dhe shtrojnë me së miri rrugën, për të mbërritur tek përmbushja me sukses e qëllimit të kësaj stërvitje", - u shpreh ndër të tjera, komandanti i Forcës Tokësore. Qëllimi i kësaj konference, ishte planëzimi dhe marrja e masave tekniko-organizative në lidhje me Grup Batalionin e Këmbësonisë së Lehtë. Stërvitja "Biza-22", e cila pritet të zhvillohet në muajin shtator të këtij viti, ka për qëllim përgatitjen dhe testimin e strukturës së Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësonisë (GBKL), për planëzimin dhe zhvillimin e operacionit mësymës, duke aplikuar procedu-



rat standarde të NATO-s, në një mjedis të përbashkët operacional, për të arritur vlerësimin dhe certifikimin kombëtar të GBKL "Combat

Ready", në përputhje me standardet e miratuara, gjatë procesit të planëzimit, ekzekutimit, vlerësimit e analizës së stërvitjes.

FORCA TOKËSORE

Përfundoi faza e Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA)

Përgjatë një periudhe pothuajse dhjetë javore, trupat që iu nënshtruan Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA), nën drejtimin e instruktorëve të Forcës Tokësore, morën njohuri dhe u aftësuan në këto lëndë bazë: përgatitje taktike, përgatitje fizike, përgatitje zjarri, ligjshmëri; edukim mbi vlerat atdhetare dhe patriotike, topografi, mbrojtje nga armët e dëmtimit në masë, përgatitje xheniere etj. Stërvitja individuale e avancuar, parashikon kalimin në tre faza aftësimi: faza e kuqe, blu dhe jeshile. Në të tre këto faza, kursantët kaluan nëpërmjet një trajnimit të rreptë dhe rigoroz, me synimin për të nxjerrë prej tyre aftësitë më të mira. SIA, u zhvillua në dy batalionet e Këmbësonisë të Forcës Tokësore, konkretisht në Batalionin I dhe atë III. Në përfundim të kursit u zhvillua edhe ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve.



Gjeneral brigade Ylli Pulaj:

Të rinjtë shqiptarë duhet ta shikojnë me prioritet pjesëmarrjen në FA, veçanërisht në radhët e Forcave Ajrore

Intervistë
me Gjeneral
brigade Ylli
Pulaj,
komandant i
Forcës Ajrore
të Forcave
të Armatosura

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI

Inderuar z. Gjeneral Brigade Ylli Pulaj, ju urojmë suksese në rrugëtimin tuaj drejt sfidave që ka Forca Ajrore, të cilën ju drejtoni! Për lexuesit tanë do ishte me rëndësi të madhe të dinin krijimin, modernizimin dhe arritjet deri në ditët tona të një ndër forcave më të rëndësishme të Forcave Armatosura, siç është Forca Ajrore.

Kur u krijua Forca Ajrore Shqiptare dhe cili është piloti që

bëri fluturimin e parë me avionin luftarak shqiptar?

Përpyqjet për të futur aviacionin në shërbim të ushtrisë kanë qenë të hershme, që në vitin 1921, por me gjithë përpjekjet e dëshirat e drejtuesve të lartë ushtarakë, kjo gjë u mundësua vetëm pas çlirimit të vendit tonë. Data zyrtare e krijimit të Aviacionit Luftarak Shqiptar është 24 prill 1951, dita kur piloti Peço Polena realizoi fluturimin me avionin e parë luftarak Shqiptar të montuar dhe të përgatitur nga specialistët e vendit tonë, i cili ishte avion me helikë, me motor me djegie të brendshme, të cilët për kohën ishin mjaft efikas. Ky fluturim historik u realizuar në Aerodromin e Laprakës, Tiranë.

Kjo armë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, pësoi ndryshime, transformime dhe modernizime të vazhdueshme, duke u pajisur me teknikën luftarake moderne të kohës dhe duke ngritur disa reparte të tjera të aviacionit Ushtarak.

Konkretisht, pas aerodromit të Laprakës, u krijuan edhe këto reparte të bazës ajrore: Reparti i parë i Aviacionit reaktiv, në Maj 1955 në Kuçovë; Regjimenti i aviacionit i Rinastit në korrik 1959; Shkolla e Lartë e Aviacionit, e cila u hap në Maj 1962 në Vlorë; Regjimenti i Helikopterëve, në Dhjetor 1967, në Farkë dhe Baza Ajrore e Gjadrit në Shkurt 1974, e cila ishte një bazë tërësisht e tunelizuar dhe kishte dy skuadrilje MIG-19 dhe një skuadrilje MIG-21.

Aviacioni Luftarak Shqiptar në atë kohë numëronte mbi 200 avionë e helikopterë, të cilët ishin të prodhimit lindor dhe operonin në të



gjithë bazat ajrore të vendit tonë.

Kush është misioni, struktura dhe detyrat e Forcës Ajrore?

Misioni i Forcës Ajrore është sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për mbrojtjen e sovranitetit të hapësirës ajrore të Republikës Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e NATO-s, mbështetja ajrore taktike për operacionet luftarake e jo luftarake të FA-ve dhe NATO-s, sigurimi i shërbimit meteorologjik, sigurimi i shërbimit të kërkim-shpëtimit ajror dhe transportit të personaliteteve të larta shtetërore.

Misioni i Forcës Ajrore realizohet nëpërmjet strukturave të saj përbërëse siç janë: Qendra e Kontroll-Raportimit e cila ka për detyrë vëzhgimin, monitorimin e hapësirës ajrore si dhe paralajmërimin në kohë për rrezikun ajror; Baza Ajrore Farkë, e cila është baza kryesore operacionale; Baza Ajrore Kuçovë, e cila ka shërbyer si bazë mbështetëse për zhvillimin e stërvitjeve ajrore të përbashkëta dhe së fundmi do të rritet roli i saj si një bazë ajrore taktike e NATO-s; Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, i cili mbulon me parashikim të motit, të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe Qendra Stërvitore, e cila është një strukturë e rëndësishme arsimore që shërben për zhvillimin e kurseve institucionale dhe profesionale të personelit të Forcës Ajrore.

Kuçovës si një aset i FA-ve, kur u krijua, dhe si u arrit modernizimi dhe roli i saj si bazë taktike e NATO-s?

Baza e Kuçovës ishte reparti i parë i Aviacionit me avionë reaktivë, e cila u krijua më 15 maj 1955, dhe fillimisht përbëhej nga dy skuadrilje avionësh reaktiv Mig-15. Në korrik të vitit 1957, për herë të parë në këtë pistë, u ul avioni bombardues "IL -28", i cili hyri në armatimin e Aviacionit tonë Luftarak. Vetëm 2 vjet pas krijimit të regjimentit, në Kuçovë, filloi përgatitja e pilotëve të klasit të parë. Në këtë bazë janë stërvitur dhe janë kualifikuar të gjithë pilotët e Forcës Ajrore, të cilët pas përfundimit të shkollës së aviacionit shkoni dhe kryenin qindra orë fluturimi me avionët e kësaj baze, ditën dhe natën, në kushte të ndryshme meteorologjike. Vit pas viti regjimenti (baza ajrore) filloi të modernizohet, ku në vitin 1966 u pajis edhe me një skuadrilje avion-

ësh të tipit MIG-17. Në të njëjtin vit, gjithashtu në këtë bazë ajrore, filluan punimet për ndërtimin e Uzinës së Riparimit të Avionëve (URA). Riparimi kapital i motorëve në Uzinën e Aviacionit përbën një moment historik për kohën, pasi hapi rrugën e vazhdimt intensiv të stërvitjes së pilotëve, si dhe forcimin e gatishmërisë luftarake në repartet e aviacionit luftarak shqiptar.

Uzina e Riparimit të Aviacionit përveç se ishte në gjendje të kryente riparimet e nivelit të tretë për avionët UTI MIG-17, AN-2, JAK-18, njëkohësisht mbështeti edhe riparimin e pajisjeve të reparteve të Mbrojtjes Ajrore, radiolokacionit dhe raketave, pasi në URA kishte pajisje dhe teknike moderne si dhe laboratorë e makineri bashkëkohore. Uzina shërbeu deri në dhjetor të vitin 2004, që daton dhe me mbylljen e fluturimeve me avionët me krah fiks.

Modernizimi i bazës Ajrore Kuçovë përmbledh ristrukturimin dhe ndërtimin e një sërë projekteve që janë të domosdoshëm për funksionimin dhe operacionalitetin e një Baze taktike Ajrore.

Këto projekte kanë të bëjnë më së shumti me përmirësim dhe modernizim të infrastrukturës ekzistuese dhe të aseteve që kjo bazë i ka trashëguar nga e kaluara.

Konkretisht në këtë bazë do të zbatohen projektet e mëposhtme:

- Rikonstruksioni i pistës ekzistuese, ndërtim i shesheve të armatim-çarmatimit, ndërtim i shesheve të parkimit të avionëve si dhe ndërtim i taxiway.
- Sistemi i furnizimit dhe shpërndarjes së karburantit të avionëve.
- Ndërtimi i depove të armatim-municionit.
- Ndërtimi i stacionit të mbrojtjes nga zjarri.
- Rikonstruksioni i Kullës së Kontrollit.

Mbështetja jonë për modernizimin e kësaj baze është në nivelin maksimal dhe po punohet me të gjithë kapacitetet e mundshme njerëzore dhe logjistike me palët e kontraktuara nga Aleanca (nëpërmjet Agjencisë së Prokurimeve dhe Mbështetjes së NATO-s (NSPA)), për realizimin e të gjithë projekteve sipas afateve të vendosura nga kjo e fundit. Krahas investimit të NATO-s edhe qeveria shqiptare

ka akorduar fonde për ta sjellë këtë bazë në të gjitha parametrat dhe standardet e një baze taktike ajrore të NATO-s. Mund të përdoren këtu projektin për ndërtimin e perimetrit të sigurisë apo projektet për sistemin e furnizimit me ujë dhe sistemin e furnizimit me energji elektrike të saj.

Prej kohësh kjo bazë nuk ishte funksionale, çfarë ndodhi me të?

Baza Ajrore e Kuçovës, ka funksionuar që nga viti 1955 deri në vitin 2005. Mbyllja e aktivitetit të avionëve luftarakë me krahë fiks, bëri që edhe në Bazën Ajrore Kuçovë të mbyllet aktiviteti i saj fluturues me avionët reaktivë.

Pas përfundimit të aktivitetit të avionëve luftarakë të të gjithë tipave, në këtë bazë pushoi zhurma karakteristike e motorëve të avionëve reaktivë dhe baza mori qetësinë e saj të pazakontë. Kjo bazë u kthye nga një simbol i aviacionit luftarak, në një bazë të heshtur dhe me një aktivitet të ndryshëm nga ai për të cilën ishte ngritur. Në këtë bazë filluan të zhvillohen fluturime stërvitore të helikopterëve tanë, ulje-ngritje të helikopterëve e avionëve të kompanive të ndryshme që operonin në vendin tonë për projekte jo ushtarake.

Gjithsesi kjo bazë filloi punën për kthimin e teknikës luftarake në kushtet e magazinimit, konservimit të saj dhe bërjen të parrezikshëm të avionëve luftarakë. Gjithashtu u bë një punë e madhe për mirëmbajtjen e aseteve të saj, dhe konkretisht pista e uljes dhe ngritjes së avionëve është rikonstruktuar dhe ka shërbyer për uljen e ngritjen e avionëve të NATO-s, gjatë stërvitjeve të ndryshme dypalëshe, për zhvillimin e stërvitjeve me pilotët e Bazës Ajrore Farkë si dhe për mbështetjen e operacioneve të ndryshme jo luftarake.

NATO miratoi propozimin e Shqipërisë për të pasur një Bazë Ajrore Taktike në territorin e saj dhe modernizimi i kësaj baze nuk është një dhuratë për Shqipërinë, por është pa diskutim një gjurmë e rëndësishme e merituar, e prezencës së NATO-s, e lobuar dhe e negociuar me të gjithë partnerët tanë dhe e gjitha kjo erdhi si pasojë e angazhimit dhe seriozitetit që Shqipëria ka treguar në çdo detyrë të marrë nga Aleanca e Atlantikut të Veriut.

Çfarë hapësirash ka, dhe a ka

ende avionë që ruhen atje?

Pista e Bazës Ajrore të Kuçovës ka një gjatësi prej 2800 milje, dhe gjerësi prej 60 milje. Kjo pistë është ndërtuar me ndihmën dhe eksperiencën e specialistëve të huaj me të cilët kemi pasur bashkëpunim në kohën që është ndërtuar dhe ka pësuar rikonstruktime të mëvonshme, duke rritur parametrat e saj dhe siguruar ulje të avionëve ushtarakë taktikë gjuajtës-bombardues si dhe avionë ushtarakë transporti të tonazhit të mesëm. Sipërfaqja e përgjithshme e Bazës Ajrore të Kuçovës është afërsisht 280 hektarë.

Kjo bazë ka vazhduar të ruhet dhe administrohet, si një aset shumë i rëndësishëm dhe i vyer për Forcat e Armatosura dhe kryesisht për Forcën Ajrore.

Atje, aktualisht, ruhen në tunelet përkatëse avionët luftarakë të tipit Mig, të cilët janë konservuar, të cilët nuk janë më në gjendje operacionale dhe janë për t'u trajtuar si skrap.

Për zbatimin e suksesshëm të misionit dhe detyrave të Forcave Ajrore është i rëndësishëm një personel ushtarak dhe civil i trajnuar mirë, i aftë ushtarakisht dhe profesionalisht. Si realizohet ky angazhim?

Realizimi i misionit të Forcës Ajrore kërkon angazhimin e një sërë strukturash dhe një numër të konsiderueshëm personeli të trajnuar për kryerjen e detyrave të ndryshme speciale.

Konkretisht Forca Ajrore kryen detyrat në përmbushje të misionit të saj kushtetues dhe realizon mbulimin Ajror të Hapësirës Ajrore Shqiptare në bashkëpunim edhe me strukturat operacionale të NATO-s, në mënyrë të pandërprerë dhe me rigorozitet.

Ajo realizon zbulim të pandërprerë të Hapësirës Ajrore Shqiptare, kryen transport të trupave dhe grupeve taktike ushtarake operacionale, luan një rol kryesor në përballimin e emergjencave civile në çdo kohë, në detyra të ndryshme si në transportin nga ajri të të sëmurve rëndë apo të plagosurve nga zona të largëta të vendit tonë, në transportimin nga ajri të ndihmave emergjente në zona të izoluar nga bora, në evakuimin nga ajri në zonat e përmbytura, në shuarjen e zjarreve në pyje, kullota etj.

"Arsimimi e mëson individin se

si të mendojë, kurse trajnimi se si të veprojë për ta realizuar". Në këtë kuadër, sa e rëndësishme është stërvitja dhe a i kemi ne mbështetjen në burimet logjistike dhe kapacitet njerëzore për ta realizuar me efikasitet këtë proces?

Trajnimi dhe stërvitja është procesi më i rëndësishëm dhe i pandarë për çdo pjesëtar të Forcave të Armatosura, që të mbajë dhe të përmirësojë aftësitë e fituara.

Trajnimi i personelit të Forcës Ajrore, është detyrë e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore Kuçovë, e cila nëpërmjet kurseve institucionale dhe funksionale, realizon rritjen e profesionalizmit të personelit sipas specialiteteve si: teknikë mirëmbajtjeje për helikopterët, kontrollor trafikut ajror, operator të shfrytëzimit të radarit dhe specialist parashikues moti.

Personeli trajnuar i Qendrës Stërvitore, është një staf i mirëkualifikuar, i cili i jep personelit që trajnohet në këtë qendër, njohuritë e duhura për të përballuar detyrat dhe sfidat për realizimin e misionit të Forcës Ajrore si dhe i pajis ata edhe me të rejtat që koha sjell për armën e aviacionit.

Për sa i përket mbështetjes logjistike, siç dihet tashmë, ekzistojnë disa vështirësi në drejtim të mirëmbajtjes së mjeteve ajrore, pasi flota jonë ajrore përbëhet nga një shumëllojshmëri tipash të helikopterëve dhe secili prej tyre kërkon specialistë të veçantë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Gjithsesi me mbështetjen e MM dhe SHP, janë realizuar të gjitha procedurat përkatëse për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes pranë kompanive të huaja jashtë vendit, të cilat janë të certifikuara për kryerjen e shërbimeve të niveleve të larta nga kompanitë prodhuese të helikopterëve.

Këtë vit shënohet 13-vjetori i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Si e shihni rolin e vendit tonë në Aleancë?

Përzgjedhja që Aleanca i ka bërë vendit tonë për të bashkëpunuar në drejtim të transformimit të Bazës Ajrore të Kuçovës, si Bazë Ajrore Taktike të saj, e tregon më së miri besueshmërinë që ofron vendi ynë në drejtim të stabilitetit dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu del në pah bashkëpunimi serioz dhe i qëndrueshëm, që Forcat e Armatosura kanë treguar dhe

vazhdojnë të tregojnë me Aleancën nëpërmjet misioneve ushtarake që kemi realizuar dhe që vazhdojmë të realizojmë.

Shqipëria ka treguar se anëtarësimi i saj në organizatën më të madhe politiko-ushtarake, ishte një arritje me meritë dhe një vlerësim serioz që vendi ynë i bën nismave të tilla të rëndësishme për vendin dhe të ardhmen e tij.

Gjatë këtyre 13 viteve që Forcat e Armatosura aderojnë në NATO, ne kemi parë se si ushtarakët tanë janë rreshtuar me dinjitet dhe profesionalizëm në krah të ushtarakëve të vendeve më të përparuara, duke marrë pjesë në shumë operacione dhe stërvitje të përbashkëta. Stërvitja që u zhvillua vitin e kaluar, "Defender Europe-21", në vendin tonë e tregoi më së miri një gjë të tillë, ku Shqipëria mori vlerësime shumë të larta nga aleatët e NATO-s dhe tregoi se një vend i vogël siç jemi ne, mund të koordinojë dhe përballojë edhe stërvitje të mëdha.

Baza Ajrore e Kuçovës do të jetë së shpejti një bazë e NATO-s, një projekt ky sa ambicioz, aq edhe i rëndësishëm, jo vetëm për sigurinë tonë kombëtare por mbi të gjitha për sigurinë rajonale. Çfarë ndihme u sjell ky projekt Forcave Ushtarake Shqiptare dhe Forcave Ajrore?

Rikthimi i Bazës së Kuçovës, në një bazë ajrore taktike të NATO-s, do të ketë ndikim shumë pozitiv dhe një përmirësim të ndjeshëm të rritjes së bashkëpunimit të Forcave të Armatosura dhe veçanërisht për Forcat Ajrore, si në drejtim të zhvillimit të stërvitjeve ajrore me pilotët tanë, në drejtim të zbatimit konkret të standardeve të Aleancës për realizimin e operacioneve të përbashkëta ajrore, në rritjen e mbështetjes logjistike të flotës tonë ajrore dhe për shkëmbimin e shërbimeve cilësore e me standarde bashkëkohore.

Ju vini në këtë detyrë në një moment të rëndësishëm, ku pritët të nisë puna për ndërtimin e bazës së Kuçovës. Pse NATO zgjodhi Shqipërinë dhe pse Kuçovën?

Siç e thamë edhe më sipër, Shqipëria, si anëtare me të drejta të plota në NATO, qysh prej vitit 2009, ka përgjegjësitë dhe detyrat e saj për të kontribuar në misionin dhe detyrat e kësaj organizate politiko-ushtarake, për mbrojtjen dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Konkretisht, vendi ynë ka kontribuar prej vitesh në shumë misione dhe operacione të ndryshme që ka organizuar NATO si në Afganistan, Irak, Gjeorgji, Letoni, Kosovë etj.

NATO ka përzgjedhur për të bashkëpunuar me ne, pasi tashmë Shqipëria është një vend partner që ka treguar dhe vazhdon të tregojë besueshmëri, stabilitet, qëndrueshmëri dhe seriozitet në bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh.

Shqipëria si një vend i vogël dhe me kapacitete modeste ushtarake, ka kontribuar në NATO nëpërmjet pjesëmarrjes së personelit ushtarak në misione të ndryshme ushtarake dhe paqeruajtëse, me ekspertizë specialistësh për trajnim dhe stërvitje ushtarakësh si dhe me specialistë për demilitarizimin e zonave të minuara në disa zona të nxehta të rajonit dhe më gjerë.

Edhe ristrukturimi e modernizimi i Bazës Ajrore Kuçovë, në bashkëpunim me NATO-n dhe kthimi i saj në një Bazë Ajrore Taktike të NATO-s, tregon angazhimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë për përmeshjen e detyrimeve që vendi ynë ka ndaj kësaj organizate. Ristrukturimi dhe modernizimi i Bazës Ajrore të Kuçovës, ka rëndësi të madhe për vendin tonë pasi e rendit Shqipërinë në krahasim të vendeve anëtare që kanë më shumë potenciale, resurse dhe kapacitete ushtarake.

Gjithashtu kjo bazë, ka një rëndësi të madhe për NATO-n, pasi ajo do të rrisë aftësitë operacionale të saj, për të operuar me më shumë efektivitet në çdo nevojë të mundshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë si dhe do të shërbejë për trajnimin dhe stërvitjet e përbashkëta të ushtarakëve tanë me ato të NATO-s.

Ky është një projekt i Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe realizimi i tij do të kushtojë rreth 50 milionë euro. Përveçse një bazë ushtarake, çfarë të mirë i sjell ky investim Kuçovës në sektorin ekonomik dhe social?

Përveç anëve pozitive të përmendura më lart në drejtim të anës ushtarake, zbatimi i projekteve të Aleancës së Atlantikut të Veriut do të ndikojnë edhe në përmirësimin e treguesve ekonomike të zonës përreth bazës së Kuçovës. Padyshim që kryerja e këtij investimi strategjik të NATO-s në vendin tonë, mundëson gjenerimin e një pakete financiare për ekonominë e

kësaj zone dhe përfshirjen e specialistëve të zonës në punësimet sezonale dhe më gjatë, bën rritjen e shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve, rritjen e besueshmërisë për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit, rritjen e përgjegjshmërisë dhe dinjitetit të shqiptarëve, duke demonstruar se vendi ynë është një aleat i besueshëm dhe partner serioz i NATO-s.

Mendonit se kjo do të jetë një mundësi e mirë për të thithur edhe pilotët e rinj?

Patjetër që është një mundësi shumë e mirë, që të rinjtë, pasi të shohin modernizimin e kësaj baze, ta shfrytëzojnë këtë risi dhe mundësi për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura dhe veçanërisht të Forcës Ajrore. Pas pothuajse një viti, ne do të presim edhe helikopterët "Black Hawk", të cilët do të jenë të parët në këtë tip helikopteri që do t'i bashkohen flotës tonë ajrore, duke bërë të mundur rritjen e kapaciteteve operacionale të saj.

Bashkëpunimi i pilotëve tanë me ato të NATO-s, në stërvitje të përbashkëta, do të jetë një tregues pozitiv për të rritur dëshirën që edhe të rinjtë shqiptarë të konkurrojnë për t'u bërë pjesë e rëndësishme të Forcave të Armatosura dhe veçanërisht të Forcës Ajrore.

Cilat janë objektivat e Forcës Ajrore dhe roli i saj në këtë bashkëpunim?

Forca Ajrore ka në objektivat e saj kompletimin edhe me mjete të tjera ajrore krahas atyre që kemi aktualisht. Ardhja e helikopterëve "Black Hawk" do ta vendosë personelin tonë fluturues përballë dhe përkrah kolegëve të Aleancës dhe do t'i angazhojë ato për rritjen e përkushtimit dhe vlerësimit që i duhet bërë trajnimit dhe stërvitjes me mjetet ajrore të gjeneratës moderne siç janë helikopterët "Black Hawk". Trajnimi që po bëjnë pilotët tanë, nëpërmjet Zyrës së Bashkëpunimit Ushtarak (ODC) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për përdorimin operacional të helikopterëve "Black Hawk", do t'u shërbejë më së miri për t'u renditur me dinjitet përkrah pilotëve të Aleancës në operacione dhe misione të përbashkëta.

Gjithashtu prioritet i rëndësishëm për Forcën Ajrore është

edhe ulja e moshës mesatare të pilotëve që kemi aktualisht, duke trajnuar një numër të konsiderueshëm oficerësh me moshë të re për t'u bërë pilotë të helikopterit ushtarak.

Kur mendohet që do jetë fluturimi i parë nga baza e Kuçovës?

Realizimi i projekteve të parashikuara për t'u kryer në Bazën e Kuçovës, marrin kohën e tyre të nevojshme dhe kjo gjë e kushtëzon edhe kohën se kur mund të jetë fluturimi i parë në bazën e modernizuar sipas standardeve të Aleancës. Në varësi të ecurisë së grafikut të punimeve, parashikohet që fundi i vitit 2023, të jetë viti i përfundimi të projekteve që sapo kanë filluar të zbatohen.

Një mesazh për të rinjtë shqiptarë, pse ata duhet të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, pse duhet të bëhen pjesë e Forcave Ajrore?

Të rinjtë shqiptarë duhet të njihen me avantazhet e të qenit pjesë e Forcave të Armatosura nëpërmjet fushatës sensibilizuese për rekrutimet në FA. Angazhimi dhe përfshirja e tyre në FA do t'i jepte atyre mundësinë e fitimit të një profesioni, do t'i siguronte atyre të ardhura mbi mesataren, të krahasuara me pozicionet e tjera të punës në fushat jashtë FA-ve, do t'i përgatiste ata për t'u përballuar me vështirësitë dhe do t'i bënte më të fortë e më të durueshëm për përballimin e problematikave të ndryshme.

Gjithashtu përfshirja e të rinjve tanë, në radhët e FA-ve, do t'i jepte atyre mundësinë e njohjes dhe bashkëpunimit me kolegët e vendeve të ndryshme të Aleancës dhe jo vetëm, me njohjen e përmirësimin e komunikimit në gjuhët ndërkombëtare dhe sprovimin e përdorimit të tyre në jetën praktike.

Të rinjtë shqiptarë duhet ta shikojnë me prioritet që të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, veçanërisht në radhët e Forcave Ajrore, pasi është edhe më tërheqëse, pasi kemi të bëjmë me një forcë në zhvillim të vazhdueshëm, që ka në përdorim teknika dhe pajisje të reja e moderne, të cilat kërkojnë përkushtim dhe të japin kënaqësi në përdorimin e tyre. Duke ju falënderuar, ju uroj suksese ju dhe efektive të Forcës Ajrore në misionin e tyre të rëndësishëm.

Përkujtohet 10-vjetori i rënies në krye të detyrës së kapiten Feti Voglit

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Sakrifika dhe gjaku i një akti të tillë nuk mund të harrohen

Në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore (FT), u zhvillua ceremonia përkujtimore me rastin e 10 - vjetorit të rënies në krye të detyrës së Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli. Pjesëmarrës në ceremoni ishin: zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Manushaqe Shehu, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bilbil Bitri, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, përfaqësues nga komisionet parlamentare të Sigurisë Kombëtare, Ligejeve, Ekonomisë, Familjarë dhe miq të Dëshmorit të Atdheut etj.

Ceremonia, u hap nga komandanti i Batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Ajet Jata, i cili fillimisht bëri një përmbledhje të ngjarjes në të cilën humbi jetën kapiten Feti Vogli. Më tej, nënkolonel Jata duke vlerësuar veprën e Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli, ndër të tjera tha: "...nga historia e ekzistencës së kombit shqiptar në këto vite, mësojmë se bijtë dhe bijat e tij kurrë nuk kanë hezitur të mbrojnë jetën, vendin dhe lirinë e tyre kur ajo është cenuar, por kapiten Feti Vogli i fali jetën vendit dhe truallit arbëror për kauzën fisnike të mbrojtjes së jetëve të pafajshme dhe lirisë së munguar, në atë vend të largët. Që prej ditës kur ka ndodhur ngjarja dhe deri më sot, vazhdojmë të nderojmë sakrificën e kapiten Feti Voglit dhe mungesa e tij është gdhendur në memorial, për të qenë prezent në jetët tona të përditshme për aktin dhe sakrificën e tij në shërbim të atdheut dhe Aleancës..."

Në vijim të aktivitetit fjalën e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili e vlerësoi kapiten Voglin si ushtarak me nivel dhe cilësi të larta, akti heroik i të cilit na mbush të gjithë me krenari. "Ushtarakët si Feti Vogli kryejnë një mision që nuk ka të krahasuar me atë të profesionëve të tjera. Ata mbrojnë atdheun, sigurinë, lirinë dhe paqen. Kapiten Feti Vogli, u largua herët nga gjiri i familjes për t'iu bashkuar piedestalit të përjetshëm të pavdekësisë. Sakrifika e tij sublime, do të shërbejë si shembull frymëzimi për çdo ushtarak. Emri i tij, do të kujtohet gjithmonë me

respekt dhe nderim ndër breza." - u shpreh gjeneral brigade Kingji.

Aktiviteti në përkujtim të rënies në krye të detyrës së kapiten Voglit, u përshëndet edhe nga zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Manushaqe Shehu. "Sakrifika dhe gjaku i një akti të tillë nuk mund të harrohen. Sot, gjithë Forcat e Armatosura me përlësi i bëjnë homazh veprës dhe kujtimit të tij. Prandaj ne jemi mbledhur këtu, për ta përkujtuar në këtë 10-vjetor të rënies në krye të detyrës heroin dhe dëshmorin tonë, ushtarakun me kontribute dhe veti të larta kapiten Feti Voglin. Ky 10-vjetor i përkujtimit të dëshmorit tonë, është një provë dhe kujtesë që Shqipëria është dhe do të jetë një vend dinjitoz i Aleancës, duke kryer misionet më të vështira në kuadër të NATO, BE dhe OKB", - tha gjeneralmajor Manushaqe Shehu

Ceremonia, u mbyll me kryerjen e homazheve dhe vendosjen e kurorave me lule, pranë bustit të Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli.

Kapiten Feti Vogli humbi jetën në Kandahar, Afganistan, 10 vjet më parë, gjatë një operacioni të Forcave Speciale, ku ai ishte pjesë e kontingjentit paqeruajtës "Eagle 4" të Batalionit të Forcave Speciale. Dëshmori i Atdheut kapiten Vogli, është pjesëtari i parë i Forcave të Armatosura që humbi jetën në një mision jashtë vendit. Vepra e tij, ngelet burim frymëzimi për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura. Në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore (FT), u





zhvillua ceremonia përkujtimore me rastin e 10 - vjetorit të rënies në krye të detyrës së Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli. Pjesëmarrës në ceremoni ishin: zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Manushaqe Shehu, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bilbil Bitri, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, përfaqësues nga komisionet parlamentare të Sigurisë Kombëtare, Ligjeve, Ekonomisë, familjarë dhe miq të Dëshmorit të Atdheut etj.

Ceremonia, u hap nga komandanti i Batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Ajet Jata, i cili fillimisht bëri një përmbledhje të ngjarjes në të cilën humbi jetën kapiten Feti Vogli.

Më tej, nënkolonel Jata duke vlerësuar veprën e Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli, ndër të tjera tha: "...nga historia e ekzistencës së kombit shqiptar në këto vite, mësojmë se bijtë dhe bijat e tij kurrë nuk kanë hezituar të mbrojnë jetën, vendin dhe lirinë e tyre kur ajo është cenuar, por kapiten Feti Vogli i fali jetën vendit dhe truallit arbëror për kauzën fisnike të mbrojtjes së jetëve të pafajshme dhe lirisë së munguar, në atë vend të largët. Që prej ditës kur ka ndodhur ngjarja dhe deri më sot, vazhdojmë të nderojmë sakrificën e kapiten Feti Voglit dhe mungesa e tij është gdhendur në memorial, për të qenë prezent në jetët tona të përditshme për aktin dhe sakrificën e tij në shërbim të atdheut dhe Aleancës..." Në vijim të aktivitetit fjalën e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili e vlerësoi kapiten Voglin si ushtarak me nivel dhe cilësi të larta, akti heroik i të cilit na mbush të gjithë me krenari. "Ushtarakët si Feti Vogli kryejnë një mision që nuk ka të krahasuar me atë të profesionistëve të tjera. Ata mbrojnë atdheun, sigurinë, lirinë dhe paqen. Kapiten



Feti Vogli, u largua herët nga gjiri i familjes për t'iu bashkuar piedestalit të përjetshëm të pavdekësisë. Sakrifica e tij sublime, do të shërbejë si shembull frymëzimi për çdo ushtarak. Emri i tij, do të kujtohet gjithmonë me respekt dhe nderim ndër breza." - u shpreh gjeneral brigade Kingji.

Aktiviteti në përkujtim të rënies në krye të detyrës së kapiten Voglit, u përshëndet edhe nga zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Manushaqe Shehu. "Sakrifica dhe gjaku i një akti të tillë nuk mund të harrohen. Sot, gjithë Forcat e Armatosura me përlësi i bëjnë homazh veprës dhe kujtimit të tij. Prandaj ne jemi mbledhur këtu,

për ta përkujtuar në këtë 10-vjetor të rënies në krye të detyrës heroin dhe dëshmorin tonë, ushtarakun me kontribute dhe veti të larta kapiten Feti Voglin. Ky 10-vjetor i përkujtimit të dëshmorit tonë, është një provë dhe kujtesë që Shqipëria është dhe do të jetë një

vend dinjitoz i Aleancës, duke kryer misionet më të vështira në kuadër të NATO, BE dhe OKB", - tha gjeneralmajor Manushaqe Shehu

Ceremonia, u mbyll me kryerjen e homazheve dhe vendosjen e kurorave me lule, pranë bustit të Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli.

Kapiten Feti Vogli humbi jetën në Kandahar, Afganistan, 10 vjet më parë, gjatë një operacioni të Forcave Speciale, ku ai ishte pjesë e kontingjentit paqeruajtës "Eagle 4" të Batalionit të Forcave Speciale. Dëshmori i Atdheut kapiten Vogli, është pjesëtari i parë i Forcave të Armatosura që humb jetën në një mision jashtë vendit. Vepra e tij, ngelet burim frymëzimi për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura.

Flet Komandanti i kontingjentit “EAGLE-4”, nënkolonel Behar MARA

Heronjve u këndohen veç këngë

Kanë kaluar plot 10 vite, ku batalioni i Forcave Speciale, pjesëtarët e kontingjentit të misionit Combat “EAGLE-4” në Kalndahar, Afganistan, mbledhen bashkë dhe kujtojnë me madhështi dhe krenari ditën e rënies në krye të detyrës së dëshmorit të atdheut Kapiten Feti VOGLI.

Ashtu si çdo vit edhe në këtë përvjetor, edhe pse ka kaluar plot një dekadë, në një ditë jo të zakonshme, krenuam dhe sollëm në kujtesën tonë atë ditë të dhimbshme për mbarë Kombit, kur për herë të parë në historikun e shumë misionëve të kryera nga FA-të, ne humbëm heroin e parë të këtij misioni të vështirë, kapiten Feti Voglin, hero i cili do jetojë gjithmonë në mendjen dhe zemrën e çdo speciali.

Duke sjellë në vëmendje dhe hapur faqet e memories, edhe sot, për mua si komandant dhe për pjesëtarët e këtij kontingjenti, kujtimet mbeten të freskëta nga ajo ditë tragjike e 20 Shkurtit 2012, ku nga një zjarr i pabesë pas shpine, shkaktuar nga polici Afgan i infiltruar në radhët e policisë, i cili hapi zjarr në breshëri ndaj Grupit në detyrë, mbeti një i vrarë dhe u plagosën dy të tjerë, (1 N/oficer shqiptar dhe 1 N/oficer amerikan). Një sulm i pabesë ideuar për të shkaktuar sa më shumë viktima në radhët e forcave të koalicionit, shkaktuar nga polici Afgan Nek Mohammad, nga Sar-i Pul, Mazari Sharif, me detyrë mitraljer (agresori që hapi zjarr, i cili kishte kohë që bashkëpunonte me rrjetin taleban). Do të doja të bëja një përmbledhje të shkurtër të ngjarjes, zonës së përgjegjësisë, detyrave të kryera nga ana jonë, si dhe një kronologji të ngjarjes së ndodhur.

“Shqipet mbjellin paqe në çdo prag
Ata i kthejnë buzëqeshjen çdo fëmije
Feti Vogli mbjell lule Shqipërie
Skënderbegas të rriti ushtria
Ku rrojnë bashkë nderi dhe lavdia
O pishtar me dritë lirie
Feti Vogli prej Shqipërie...”



Misioni “Eagle 4” i Forcave Speciale, që la gjurmë të thella dhe kujtohet me krenari nga pjesëtarët e Forcave Speciale, por edhe nga përfaqësues të lartë të shtetit dhe ushtarakë të lartë Amerikanë.

Zona e Përgjegjësisë e Trupave tona

Trupat tona EAGLE kryenin detyra speciale në të gjithë zonën e përgjegjësisë së Skuadronit 2-38 dhe Brigadës 504 të Survejimit të largët të fushëbetejës (504th Battlefield Surveillance Brigade, Combined Task Force Viper, Afghanistan). Zona e përgjegjësisë përfshinte një sipërfaqe rreth 14.000 km² me një thellësi rreth 86 km dhe gjerësi të madhe prej 188 km

vijë kufitare me Pakistanin. Një zonë e vështirë nga pikëpamja e terrenit, jo vetëm për sa i përket madhësisë por edhe terrenit, i cili shtrihet me male të thepisura të pakalueshme, tërësisht të minuar, në korridore të cilët përdoren nga Talebanët për trafikimet e paligjshme, jo vetëm të lëndëve narkotike, eksplozivëve dhe armatimeve. Zona e përgjegjësisë përfshin arterien kryesore të jugut në kufirin me Pakistanin, e ndodhur vetëm 6 km



në kufirin me Pakistanin, e cila ishte Epiqendra e rrjetit dhe Organizatave Terroriste Talebane, e quajtur ndryshe kreyqyteti i talebanëve.

Cila ishte situata e sigurisë në zonën e operacionit

Situata e sigurisë në zonën ku operonim ishte tepër e komplikuar dhe e rrezikshme, pasi sipas informacioneve periodike të vazhdueshme të marra nga shërbimet e inteligjencës të komandës operacionale USA, (Skuadroni 2-38), si dhe mbështetur informacioneve të inteligjencës në rrjetin e klasifikuar të ISAF, në zonën tonë të përgjegjësive ka pasur vazhdimisht lëvizje të theksuara të elementëve terroristë talebanë, këta elementë mund të organizonin sulme të kombinuara kundër forcave të koalicionit dhe forcave të sigurisë afgane, në ZO. Të dhënat e fundit të zbulimit ishin se midis radhëve të policisë kishte elementë të inkriminuar dhe korruptuar që mund të përdoren, si vetëvrasës, duke infiltruar persona të tjerë brenda radhëve të policisë, duke i ndihmuar ata, me uniforma dhe dokumente identifikimi të rreme, me qëllim sulmin ndaj forcave të koalicionit (ISAF), gjatë stërvitjes ose trajnimeve me forcat e sigurisë Afgane, në zonën e Spin Boldokut. Pra, nisur nga kjo situatë e veçantë, ishte tepër e vështirë nga ana e shërbimeve të inteligjencës dhe ana jonë të identifikonim dhe skanonim elementët e policisë Afgane të infiltruar brenda radhëve të policisë, të cilët në çdo kohë ishin një minë me sahat nga brenda forcave të koalicionit. Kontingjenti "EAGLE-4" ka vepruar në përbërje të skuadronit 2-38 të Brigadës së survejimit 504, (zbulimit të largët USA), si dhe duke kooperuar me partnerët Afganë (forcat e sigurisë Afgane), duke kryer detyra të ndryshme Speciale, si:

- Operacione të goditjes direkte me desantim nga ajri. (Ndjekja, goditja dhe arrestimi i objektivave të veçantë (Elementë Talebanë të rrezikshëm).
- Kryerja e zbulimit special në korridoret e infiltrimeve të elementëve terroristë talebanë.
- Shoqërimi i personaliteteve civile dhe ushtarake në zonat urbane dhe zona të rrezikshme.
- Kryerja e patrullimit dhe pika kontrolli taktike, si dhe detyra të planëzuara për goditje flesh nga ajri dhe toka, për të goditur dhe ndërhyrë në situatat e veçanta brenda zonës së përgjegjësive.

Si ndodhi ngjarja që çoi në fatalitet për trupat tona dhe kush ishte polici Afgan që hapi zjarr ndaj forcave të koalicionit

Kronologjia e ngjarjes. Grupi i Specialit drejtuar nga Kapiten Feti Vogli, në bashkëpunim me grupin USA në përbërje të skuadronit 2-38, si dhe forcat e sigurisë afgane, duke filluar nga data 20.02.2012 ora 12:30, kishte marrë për detyrë të kryejë detyrë patrullimi, si dhe shoqërimin dhe sigurim të një ekipi USA, (Inteligjencë dhe USAID) brenda zonës së përgjegjësive në zonën ROBAT; kryerjen e një takimi me krerët lokalë Afganë, për inspektimin e gjendjes së një shkolle dhe një qendre shëndetësore, me qëllim kthimin e tyre në gjendje normale infrastrukturore, në shërbim të komunitetit. Lëvizja për këtë detyrë do të fillonte nga ora 12:30, e datës 20.02.2012, duke filluar lëvizjen nga baza Spin Boldal - Objekti Atlantit - Pika e Kontrollit Nr. 7, në drejtim të Pikës së Kontrollit Rajonal Nr.1, duke vijuar lëvizjen drejt Fshatit Daman (zona Robot). Kjo detyrë ishte planifikuar të realizohej brenda datës 20.02.2012, jo më vonë se ora 20:00.

Rreth orës 17:00, grupet e partnerizura një grup shqiptar SF, një grup USA dhe grupi i policisë Afgane lëvizën në drejtimin e përcaktuar dhe u vendosën pranë shkollës "Doman" për të kryer inspektimin dhe marrjen e takimit me krerët lokalë të kësaj zone. Pasi grupet në detyrë u stacionuan rreth shkollës dhe krijuan perimetrin e sigurisë, ku dhe një pjesë e grupeve po kryenin inspektimin brenda shkollës rreth orës lokale 16:25, polici Afgan Naik Muhammed, me detyrë mitraljer, i cili qëndronte mbi mjetin e policisë tip Ford-Ranger, hapi zjarr me breshëri me Mitroloz model 56 në drejtim të forcave tona dhe atyre Amerikane. Nga ky sulm i pabesë mbeti i vrarë duke mos i mbijetuar plagëve të marra Kapiten F. Vogli dhe plagosur rëndë 2 N/officerët, tetar Aleksander Peci dhe rreshteri amerikan MSG Trost. Të ndodhur përballë këtij sulmi të pabesë pas shpine Grupi Special së bashku me Grupin Amerikan janë kundërpërgjigjur me shpejtësi, duke neutralizuar dhe arrestuar të gjithë policët Afganë në detyrë. Ata ngritën duar lart, duke u dorëzuar dhe mos bërë rezistencë.

Në këtë situatë pavarësisht kundërpërgjigjes së shpejtë të dhënë, duke hapur zjarr ndaj agresorit përballë kësaj, së bashku me forcat amerikane, nga ku edhe kishim varësinë operacionale, na u desh të zbatonim rregullat e Angazhimit ROE dhe konventat për të dorëzuarit dhe ndaluarit. Tashmë i gjithë grupi prej 11 vetash ishte i ndaluar dhe arrestuar nga ana jonë në pritje të veprimeve hetimore nga organet kompetente të komandës rajonale CR të ISAF. Në orën 17:15, të plagosurit u nisën me helikopter MEDEVAC në spitalin ROL-3 në Kaldahar, duke arritur në spital rreth orës 17:30. Më kujtohet dhe do sillja në vëmendje faktin se gjatë transportimit me helikopter në ishte raportuar nga qendra operacionale se Tetar Peci kishte ndërruar jetë, por pas mbërritjes në spital gjatë ekzaminimit më të specializuar doktorët thanë se ai kishte shenja jete edhe pse kishte marrë plagë të rënda nga 3 plumba në kokë dhe pjesë të tjera të trupit. Më pas, pas ndërhyrjeve kirurgjikale të specializuara dhe dërgimin e tij në spitalin e NATO-s në Gjermani, tetar Peci mundi t'i shpëtonte plagëve të marra dhe të kthehej në gjendje të mirë shëndetësore.

Cili ishte polici afgan që hapi zjarr, çfarë deklaroi ai gjatë marrjes në pyetje

- Emri: NEKE MOHMAD, nga Sar-i Pul, Mazari Sharif, me detyrë mitraljer



(agresori që hapi zjarr).

- Moshë: 24
- Etnia: Parioziy
- Detyra: Pjesëtar i Policisë Afgane, CPR-2, (Pikë Kontrolli Rajonale).

Ky ishte polici dhe personi që hapi zjarr mbi efektivat tanë, i cili, sipas pretendimeve të tij kishte rreth një vit që punonte si punonjës i policisë afgane. Ky person deklaroi se punëdhënësi i tij ka qenë Gul MUHAMAD, që nga bisedimet e mëvonshme u kuptua që ky ishte edhe komandanti i PKR-2. Një nga pretendimet e tjera të tij është se Juma KHAN i ka thënë këtij personi që nesër do të vijë trupa të koalicionit në zonë dhe se ky duhet të sulmojë këto të fundit. Gjithashtu, agresori pretendonte se gjatë aktit të sulmit ka qenë nën efektin e drogës të llojit opium, e dhënë kjo nga Juma KHAN, përsëri sipas pretendimeve të tij, ku një sasi e konsiderueshme i është gjetur në një nga xhepat e xhaketës. Kjo sasi opiumi u sekuestrua nga autoritetet përkatëse mbas mbërritjes në vendngjarje si provë materiale. Agresori gjithashtu pretendonte se Juma KHAN ishte pakistanez dhe merrej me furnizimet logjistike të PKR-2.

Gjatë marrjes në pyetje taktike nga grupi në detyrë, rezultoi se:

Kishte marrë opium nga Juma, (i ndaluar i tretë). I ishte thënë nga ky i fundit, të bëhet gati se diçka e keqe do të ndodhte dhe të kishte armën e mbushur. Ka hapur zjarr ndaj forcave të koalicionit me urdhër të Juma-s. Kishte qenë mitraljer i Gulit (komandantit të Check-point nr:2) qysh prej 6 muajsh. Nuk shkon mirë me Juma-n dhe ka probleme me autoritetet e policisë. Nuk kishte përfunduar shkollë policie.

Mbas analizimit të informacioneve

të mbledhura dhe rrjedhës së ngjarjeve, dyshohet se sulmi mbi Forcat e ISAF ka qenë i paramenduar dhe i mirë organizuar nga agresori, Komandanti i PKR-2 dhe zëvendësi i tij.

Pas përfundimit të hetimeve, përfundimisht, 3 policët e implikuar në ngjarje u dënuan: 1. Neke MOHMAD, me burgim të përjetshëm; 2. Gul MUHAMAD dhe 3. Juma KHAN me nga 20 vite burg.

Si e përjetuam këtë ngjarje kontingjenti "EAGLE-4", ndikimi në moralin dhe tempin e përmbushjes së misionit

Misioni "Combat EAGLE" ishte mision i vështirë jo vetëm nga detyrat që kryenim, terreni i vështirë në zonën e përgjegjësisë ku operonim, por vështirësitë shtoheshin edhe për vetë faktin që forcat e sigurisë Afgane me të cilët operonim ishin jo të gatshëm dhe integruar për të kryer detyra të përbashkëta me forcat e koalicionit ISAF. Ngjarja e ndodhur edhe pse nuk ishte e para në morinë e incidenteve "Green" e "Blue", ndërmjet forcave të sigurisë Afgane dhe atyre të koalicionit, ngjarje e cila na hidhëroi së tepërmi; nuk është e lehtë të humbësh njerëzit tuaj të krahëve edhe pse isha komandant me përvojë për herë të tretë në misione të ndryshme në Afganistan dhe Irak, por edhe pjesëtarët e kontingjentit të gjithë ishin me përvojë në këtë drejtim e përjetuam me dhimbje të thellë. Por nga ana tjetër ishim të vendosur se nuk do të dorëzoheshim përballë sfidave dhe rreziqeve edhe pse ngjarja ndodhi në muajin e parë, ku edhe për 5 muaj të tjerë detyra dhe rreziqe të tjera na pritnin. Pas 3 ditësh bëmë ceremoninë mortore, ku heroin tonë e nderuan të gjithë ushtarakët e lartë të komandës rajonale të ISAF dhe më pas trupi i tij u nis dhe riatdhesua në Shqipëri. Plagë e rëndë për kontingjentin, familjen,

kombin për humbjen e birit të tyre. I gjithë shteti dhe populli në këmbë e nderuan me ceremoni madhështore, si dhe dhënien e titullit të lartë dëshmori i atdheut.

Si komandant kontingjenti, së bashku me gjithë personelin e kontingjentit e kthyem dhimbjen në forcë, na duhej të çonim përpara, pa u ndalur, detyrat që na prisnin. Ndryshuam taktikë dhe strategji në mënyrën e sjelljes dhe bashkëpunimit me forcat e sigurisë Afgane, besimi ndaj tyre tashmë ishte lëkundur po dhe rregullat e angazhimit tashmë ishin më strikte në zbatimin e tyre, nuk kishte më tolerim për askënd. Nuk na mposhtën dot as dhimbja as frika, por edhe dinakëria dhe mjedisi i egër ku kryenim detyrat. Ditën e katërt pas ngjarjes së rëndë Komanda Amerikane, nga ku kishim vartësinë operacionale, e cila na ka mbështetur në gjithçka nga pikëpamja logjistike, por edhe duke na parë si pjesë integrale e tyre, u habitën që ne informuam se ishim të gatshëm të shkonim përsëri në zonën e përgjegjësisë, në rajonin ku ndodhi ngjarja dhe se ne nuk do ndaleshim deri në përmbushjen e misionit tonë.

Për 5 muaj ne kemi kryer detyra të vështira nga të cilat 13 operacione 72-orëshe, me infiltrim nga ajri në terrene të vështira, kundër objektivave terroristë Talebanë, apo detyra të tjera zbulimi. Ishte detyra jonë, si komandant e kontingjentit, të mbanim lart moralin dhe të lartësonim figurën e heroit tonë kapiten Feti Voglit, por edhe të tetar Peçit, i cili mahnti forcat e ISAF-it, ku vetëm 2 muaj i ndodhur në spital në Gjermani lutej të kthehej përsëri në mision. Pra ishte forca e secilit pjesëtar të kontingjentit që më obliguan akoma më shumë të qëndronim së bashku të bashkuar, duke mbajtur lart moralin, të përmbushnim misionin dhe të ktheheshim faqebardhë në atdhe, jo me humbje të tjera. Misioni u përmbush pavarësisht humbjes së heroit, duke qenë krenar se vepra e tij do të rrojë gjatë në pedestalin e pavdekësisë, duke lënë pas një emër të mirë, të një heroit që nuk vdes kurrë. Duke e mbyllur këtë kthim në memorie, e cila nuk harrohet kurrë dhe në këtë 10 vjetor, ashtu si çdo vit tjetër, figura e kapiten Feti Voglit kujtohet dhe nderohet jo vetëm nga personeli i Forcave Speciale, por nga të gjithë strukturat e MM dhe SHP, pse jo edhe nga personalitete politike dhe ushtarakë të lartë Amerikanë, me të cilët kemi pasur nderin të bashkëpunojmë dhe të mbështetemi prej tyre.

Gjeneralmajor Shehu: EOD është një nga kontributet tona dinjitoze në kuadër të Aleancës në Letoni, që na bën krenar

Në Qendrën Stërvitore u zhvillua ceremonia me rastin e përfundimit të Kursit X të nivelit I EOD. Në këtë ceremoni morën pjesë: zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, shefi i Zyrës së ODC nënkolonel Erol Munir, drejtori i Drejtorisë Logjistike në SHPPFA kolonel Aleksandër Pando e komandantë të reparteve të KM. Në fjalën e hapjes së ceremonisë, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Ylli Zyla falënderoi të pranishmit për vëmendjen dhe kujdesin e shtuar ndaj trajnimit dhe stërvitjes në Forcat e Armatosura. Ai theksoi rëndësinë e këtij kursi në marrjen e njohurive të domosdoshme bazë për asgjësimin e municioneve të paplasura duke evituar rrezikun për personelin në operacion, për komunitetin dhe zonën e duke falënderuar kursantët për përkushtimin dhe finalizimin me sukses të këtij kursi. Më pas fjalën e mori zëvendëshefi i SHPPFA gjeneralmajor Shehu e cila pasi u përcolli kursantëve urimin në emër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, theksoi vlerën e këtij kursi si konsolidim i një prej kapaciteteve të rëndësishëm në rang force të armatosur, rëndësia e të cilit do të kuptohet më mirë gjatë operacioneve reale EOD. “Zhvillimi dhe konsolidimi i kapaciteteve operacionale të EOD, ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e Komandës Mbështetëse dhe të Forcave të Armatosura. Modernizimi teknik, me sisteme dhe pajisje të reja dhe të kohës, ka qenë dhe do të jetë vazhdimisht një nga komponentët bazë për sigurimin e kapaciteteve EOD të qëndrueshme, por po kaq e rëndësishme dhe thelbësore është përgatitja profesionale e personelit që do të angazhohet në këtë shërbim të veçantë. Aftësimi i lartë profesional, jo vetëm i jep vlerën e vërtetë teknologjisë moderne, por e shumëfishon atë.” Më tej gjeneralmajor Shehu do të vinte në dukje edhe detyrat e realizuara nga

“Në këto misione do të përjetoni madhësinë dhe rëndësinë e detyrës, si dhe do të kuptoni vlerën e madhe të këtyre kurseve e trajnimeve”



shërbimi i EOD, i cili është aktivizuar dhe angazhuar praktikisht në detyra reale luftarake dhe/ose jo luftarake, në operacione brenda dhe jashtë vendit, të cilat janë gjithmonë jo vetëm detyra të rëndësishme, por shpeshherë edhe të rrezikshme. “Për këtë arsye serioziteti, standardi, disiplina, kërkesa dhe përkushtimi i dyanshëm instruktor-kursant është përcaktues për nivelin, mbarëvajtjen dhe suksesin e tij. Fakti që sot arrijnë të certifikohen vetëm 50% e kontingjentit që filloi me vullnet, dëshirë dhe pasion këtë trajnim, është domethënëse. Ky është një tregues i qartë i kërkesave dhe standardeve të larta që ka kjo përgatitje profesionale e këtij shërbimi delikat të Forcave tona të Armatosura. Pa dyshim që rezultatet janë gjithmonë produkt i një pune të përbashkët, të angazhimit dhe përpjekjeve të një ekipi të përbashkët. Të kryesh me sukses një përgatitje dhe trajnim të rëndësishëm, sikurse është ky kurs specifik, dhe për më tepër edhe në kushte ende relativisht të vështira, kufizuese dhe bllokuese për shkak të pandemisë së tej zgjatur, është një sakrificë jo vetëm për kursantët, por një sfidë e vërtetë edhe për instruktorët, drejtuesit dhe komandantët tuaj.

Gjej rastin, që të shpreh një falënderim të veçantë për miqtë tanë, për

Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak (ODC) dhe Zyrën e Atasheut Ushtarak të aleatit tonë të madh, SHBA, për vëmendjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që kanë treguar edhe për zhvillimin dhe modernizimin tekniko-profesional të këtij shërbimi të rëndësishëm të Forcave tona të Armatosura. Gjithmonë dhe për gjithçka, miqtë tanë amerikanë kanë dhe do të kenë gjithë mirënjohjen tonë! Shërbimi ynë EOD është një nga kontributet tona dinjitoze në kuadër të Aleancës në Letoni, që na bën krenar, por zhvillimet e parashikuara e të paparashikuara që po përjetojmë në krahun lindor të NATO-s, mund të na kërkojnë edhe për angazhime e detyra të tjera. Në këto misione do të përjetoni emocionet, madhësinë dhe rëndësinë e detyrës, por do të ndjeni dhe kuptoni vlerën e madhe të këtyre kurseve e trajnimeve. Jua thashë këto që të kuptoni dhe të mbanin në mendje që përgatitja dhe stërvitja nuk mbaron këtu. Aftësimi vazhdon çdo ditë, krahas detyrave që do të kryeni. Natyrisht që ju do të kaloni edhe në kurset e niveleve më të larta, por puna juaj e përditshme me pasion dhe dashuri, është ajo që do t’ju mësojë dhe aftësojë më shumë e më mirë. Kam besim në vullnetin dhe përkushtimin tuaj.”

Komanda mbështetëse

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia: Lidhja e zonave rurale nëpërmjet urave “Bailey”, tregues mbështetjeje në çdo situatë krize

Ndërtimi i kësaj vepre prej 18 m, e me peshëmbajtje 40 ton është një kontribut tepër i rëndësishëm për lidhjen e komunitetit e kësaj zone, ndaj ju falënderoj sot për punën e palodhur dhe ndërtimin e kësaj ure, e cila nuk është e vetmja pasi kjo kompani vijon punimet edhe në qytetin e Pukës

Pas një punë prej më shumë se një jave, si pasojë e amortizimit të urës së vjetër të zonës, xhenierët e kompanisë së urave të Komandës Xheniere kanë përfunduar me sukses ndërtimin e urës xheniere tip “Bailey” në fshatin Shebë, njësi administrative Kthellë të bashkisë Mirditë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Përparim Gega, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Hajdar Gurra si dhe zëvendëskryetarja e bashkisë Mirditë znj. Vitore Gjini.

Komandanti i KM, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia gjatë fjalës së tij falënderoi efektivin e Kompanisë së Urave dhe u shpreh se: “Lidhja e zonave rurale nëpërmjet urave “Bailey”, që ndërtojnë

xhenierët e Komandës Mbështetëse janë një tregues i mbështetjes në çdo situatë krize për popullsinë në nevojë, mbështetje e cila do të vijojë. Ndërtimi i kësaj vepre prej 18 m, e me peshëmbajtje 40 ton është një kontribut tepër i rëndësishëm për lidhjen e komunitetit e kësaj zone, ndaj ju falënderoj sot për punën e palodhur dhe ndërtimin e kësaj ure, e cila nuk është e vetmja pasi kjo kompani vijon punimet edhe në qytetin e Pukës.”

Nga ana e saj znj. Gjini falënderoi forcat xheniere dhe gjeneral brigade Ilir Xhebexhinë për mbështetjen nga Forcat e Armatosura në ndërtimin e kësaj vepre në kohë rekord, e cila shërben në interes të rreth 1000 banorëve të fshatrave Shebë, Malaj dhe Trojes, në lidhjen e komunikimit për shërbimet e nevojshme në jetën e përditshme, ekonominë dhe mos shpopullimin e zonës.





Përfundimi dhe Certifikimi i Kursit të Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA), në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi

Mbyllet me sukses kursi i Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA), në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, në specialitetet Këmbësori dhe Ndërlidhje. Në këtë ceremoni morën pjesë dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë Kolonel Flamur Hadushi, shefa departamentesh të AFA-së, instruktorë përgjegjës të QAPU-së dhe kursantët e SIA-s. Në fjalën e tij përshëndetëse dekani i FMS Kolonel Hadushi, përshëndeti dhe uroi kursantët që përfunduan Kursin e Stërvitjes Individuale për rezultatet e arritura në të gjitha disiplinat e programit stërvitor 10 javor. Ai i përcolli edhe përshëndetjet e Komandantit të AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, për këtë ditë të shënuar në karrierën e tyre ushtarake. Gjithashtu dekani i FMS-së në fjalën e tij u ndal dhe në konsolidimin e mëtejshëm të shoqërisë ushtarake të krijuar



deri tani dhe i motivoi kursantët që të vijojnë pasurimin e karrierës së tyre me kurse të tjera për të shërbyer edhe si nënoficerë në

FA. Në këtë kurs u certifikuan 57 ushtarë/detarë të I-rë, të cilët përfitojnë gradën ushtar/detar i II-të.

Përkujtojmë heronjtë dhe dëshmorët e kombit dhe themi se gjaku i tyre është në themelin e shtetit të ri të Kosovës. Përpjekjet e atdhetarëve shqiptarë me shekuj kishin për qëllim çlirimin e trojeve shqiptare dhe rikthimin e flamurit të Shqipërisë së Skënderbeut, Naimit Frashërit, Çerçiz Topullit, Ismail Qemalit, Isa Boletinit, Hasan Prishtinës, Adem Demaçit, Ukshin Hotit, Adem Jasharit, dhe të shumë dëshmorëve e heronjve të kombit që dhanë gjakun për liri.

Respekt e nderim për arkitektin historik të Pavarësisë së Kosovës, Presidentin e parë, Dr. Ibrahim Rugova.

“Gëzuar Pavarësinë, Kosovë! Gëzuar këtë ditë të madhe për të gjithë shqiptarët! Sot, ne jemi të gjithë me mendje dhe me zemër në Kosovë. Përulemi para veprës së mijëra bijave e bijve të Kosovës dhe mbarë kombit që luftuan e sakrifkuan për këtë ditë të madhe.

Kosovë e së tashmes dhe e së ardhmes, të urojmë edhe shumë ditëlindje tjera, me shpresën që e ardhmja juaj e afërt të jetë pjesë e Aleancës Euro-Atlantike – NATO si dhe Bashkimit European.

E ardhmja e të gjithë shqiptarëve është e bekuar. Gëzuar Kosovë e shtrenjtë! Gëzuar shqiptarë kudo në botë!”





Kolonel HYSNI GJERGJI,
Shef Grupi IKSHU

Konflikti ne Ukrainë

Përfundimi i luftës së ftohtë në 1991, shpërbërja e Traktatit të Varshavës dhe rënia e murit të Berlinit, për shumë studiues ushtarakë dhe të gjeopolitikës, u deklarua edhe si fundi i misionit të NATO-s. U hodhën ide edhe për shpërbërje, pasi aleancës së Atlantikut të Veriut i mungonte blloku ushtarak armik, apo një shtet kërcënues për sigurinë e anëtarëve të saj. Por sulmi në Gjeorgji dhe pushtimi i Krimesë në 2014, treguan që kërcënimi rus (sovjetik) ishte rizgjuar. Këto fakte vazhdojnë të bindin çdo ditë e më shumë të gjithë skeptikët, që NATO është e domosdoshme, aleanca është në misionin e saj të duhur dhe historik edhe sot në 2022. Rusia në strategjinë e sigurisë kombëtare të saj deklaroi se NATO-ja vazhdon të etiketohet si fuqi kryesore armike e sigurisë kombëtare të Rusisë, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe perëndimi, i propagandohen qytetarëve rusë si shkaktarët e vetëm të varfërisë dhe rënies së tyre ekonomike.

Por a do të ketë luftë në Ukrainë? Ka vetëm një njeri në planet, i cili mund ta dijë me siguri këtë përgjigje që është Vladimir Putin. "Kjo përgjigje varet nga versioni i liderit rus që ne zgjedhim të besojmë dhe i cili do të marrë vendimin: Një "Putin Racional" apo një "Vladimir i Çmendur". A do të jetë Ai lider i luftës apo strateg i paqes", -shkruan për "Financial Times", Gideon Rachman. Shumë politikë-bërës perëndimorë besojnë tek "Putini Racional" pasi argumentojnë dhe besojnë se pas më shumë se 20 vjetësh në pushtet, lideri rus është i njohur për sjelljet dhe taktikat e tij racionale dhe të zgjuara. Të tjerë që



në Donetsk. Putin nuk është bankier, filozof, profesor universiteti apo ekonomist. Profesionin dhe biznesin e tij ai ka luftën, pasi është arsimuar, trajnuar dhe stërvitur si ushtarak si dhe ka pasur karrierë në kundërspiunazhin rus, gjatë luftës së ftohtë. Ai njih shumë mirë historinë e luftërave të mëparshme, ndërsa në Luftën e ftohtë ka qenë një drejtues i inteligjencës ruse në Gjermaninë Lindore. Lufta e Ftohtë dhe ngjarjet e saj i kanë dhënë një përvojë të konsiderueshme atij, dhe kjo duket në mënyrën sesi ai po drejton superfuqinë ruse.

Situata kërcënuese e Kremlinit kundër Kievit sot po zë faqen kryesore të shtypit ndërkombëtar, si dhe aktivitetin diplomatik të organizmave ndërkombëtare NATO, BE dhe OKB. Kjo paraqitet para popullit rus si një arritje e Moskës, pasi gjithë bota i ka sytë dhe vëmendjen tek Rusia duke e rivlerësuar fuqinë dhe rolin e saj si superfuqi edhe një herë tjetër pas disa dekadash. Pikërisht edhe në këtë fillim viti të 2022 situata ngjan si para 60 viteve, gjatë luftës së

ftohtë. Sot shtetet në konflikt nuk janë thjesht Rusi - Ukrainë, por Rusia përballë SHBA-së dhe NATO-s, ku palët janë posedues edhe të armëve bërthamore. Ky fakt e bën konfliktin të ngjashëm, shumë të rrezikshëm nëse ndodh, si dhe "jo racional" për hir të shkatërrimit të paimagjineshëm që do të arrihej nëse do të përdroreshin këto armë.

"Pushtim" është fjala më e përdorur prej më shumë se një muaji në të gjitha mediat dhe deklaratat e liderëve botërorë. Pushtimi në terma ushtarakë dhe gjeopolitikë, nënkupton marrjen nën kontroll ushtarak të një shteti sovran nga një shtet

Drejt "racionalitetit" apo "çmendurisë"?

besojnë në "Vladimirin e Çmendur", nisen nga fakti i fundit i liderit rus për botimin e eseve dhe retorikave me frymë nacionaliste. Në korrik 2021, ai shkroi mbi: "Unitetin historik të rusëve dhe ukrainasve", dhe një ese mbi "Origjinën e Luftës së Dytë Botërore", duke pretenduar se Britania dhe Franca, kishin inkurajuar qëllimisht Gjermaninë të sulmonte Bashkimin Sovjetik. Ata që besojnë tek "Putini Racional", argumentojnë se udhëheqësi rus, ka më shumë gjasa të ndërmarrë veprime të kufizuara ushtarake, vetëm në Ukrainën Lindore, ku po zhvillohet nga 2014 një konflikt i nivelit të ulët midis ushtrisë ukrainase dhe forcave pro-ruse

tjetër. Sipas historisë, luftërat kanë filluar, janë ndërprerë dhe kanë përfunduar në tavolinat e politikanëve, pas fushatave ushtarake apo pas marrëveshjeve diplomatike "Luftërat mund të bëhen nga armët, por ato fitohen nga njerëzit" -shkruan Gjenerali George Patton. Historia e largët por edhe e afërt e luftërave, na mëson se sa e vështirë është marrja nën kontroll e një populli dhe një territori të caktuar me mjete të pastra luftarake dhe kryesisht me "fuqi të ashpër". "U deshën 20 vjet angazhim ushtarak, trilionat dollarë të shpenzuar, katër presidentë dhe mijëra jetë të humbura nga ana e SHBA-së, për të ndryshuar regjimin në Afganistan: nga taleban në taleban", -shkruan me sarkazëm "The Economist". Në Ukrainë popullsia po përgatitet për luftë, përfshirë gra dhe fëmijë duke u stërvitur për të mbrojtur atdheun e tyre. Kjo ndërgjegje e rezistencës popullore është shumë here më e rëndësishme dhe e pathyeshme, se sa tanket dhe raketat të komanduara nga ushtarakë rrogëtarë, që po sulmojnë një vend sovran. "Forca e mureve të kështjellës, është sa guximi i atyre që i mbrojnë këto mure", -na mëson Genghis Khan nga shekulli i XII-të. Sigurisht "Putini racional" i ka studiuar shumë mirë këto leksione, dhe kurrë nuk do dëshironte të kishte fatin e të ngjashmëve të tij të mëparshëm. Putin është mjeshtër i teorisë dhe praktikës së luftës hibride, i gërshetimit të luftës politike, diplomatike, ushtarake dhe informative. Në të gjithë Europën, pa përjashtim, Putin po drejton atë që di të bëjë më mirë: luftën me kibernetikë, kërcënim ekonomik për bllokim të furnizimit me gaz të Europës, spiunazh, sabotazh dhe subversion të nisur që nga lufta e ftohtë. "Moska është përpjekur të minojë institucionet demokratike të Ukrainës, ka ndërhyrë në politikën e brendshme dhe zgjedhjet e Ukrainës, ka bllokuar energjinë dhe tregtinë për të frikësuar dhe shantazhuar, ka përdorur propagandën dhe keqinformimin, për të mbjellë mosbesim si dhe ka ndërmarrë sulme kibernetike", -deklaroi Sekretari i SHBA-së Blinken, më 1 shkurt 2022. Së fundmi, më 9 shkurt 2022 institucionet bankare europiane dhe botërore alarmohen nga një sulm i mundshëm i koordinuar i hackerave rusë në sistemin monetar ndërkombëtar.

Është tashmë e vërtetuar, se Moska ka përdorur dhe po përdor

ndërhyrjet në zgjedhjet politike të vendeve të ndryshme, me qëllim manipulimin e procesit politik të zgjedhjeve në Europë, SHBA dhe Ballkan, duke mbështetur personalitete pro-rusë.

Në dhjetor të 2021, teksa trupat ruse ishin të grumbulluara pranë kufirit të Ukrainës, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky paralajmëroi vazhdimisht mbi rrezikun e një grushti të mundshëm shteti në Kiev, të planifikuar nga Moskë dhe oligarkët pro-rusë në Ukrainë. Qëllimi i këtij grushti shteti do të jetë vendosja e një qeverie të re pro-ruse në Ukrainë, e cila do kishte të drejtë të kërkonte zyrtarisht për ndërhyrje



forcat e CSTO-së, siç ndodhi në Kazakistan. Kërkesa e një qeverie qoftë edhe "të përkohshme" për ndërhyrje nga jashtë do të siguronte sado pak legjitimitet për të filluar një proces pushtimi nga brenda të Ukrainës duke bërë anëtarësim të saj në CSTO.

Ministria e jashtme britanike, më 6 shkurt 2022, deklaroi se ka informacione në lidhje me kontaktet ndërmjet shërbimeve sekrete ruse me katër personalitete të tjera politike të Kievit, ish-kryeministri Mykola Azarov, ish-zëvendëskryeministrat, Serhiy Arbuzov dhe Andriy Kluyev, si edhe ish-zëvendësshefi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Vladimir Sivkovich, të cilët kanë qenë të gjithë në detyrë në kohën e presidentit të konsideruar pro rus, Viktor Yanukovich, larguar nga pushteti në vitin 2014. Kandidati për kryeministër i mbështetur i Moskës në Ukrainë është ish-deputeti, Yevhen Murayev. "Presioni dhe qëllimi për të fituar pa luftë, por nëpërmes demonstrimit

të fuqisë së armëve dhe ndërhyrjes nga brenda, ka qenë synimi i të gjithë luftërave", -shkruan Sun Tzu tek Arti i Luftës.

Në fund të këtyre analizave arrihet në përfundimin që: nuk do ketë një "pushtim" nga jashtë vetëm me "fuqi të ashpër", ose një luftë konvencionale në Ukrainë, por nëse ndodh rezulton të jetë vetëm një luftë lokale, hibride dhe duke përdorur fuqinë "smart" si kombinim të fuqisë "hard" dhe "soft".

Një leksion tjetër që na jep historia e luftërave është se, shtetet nuk do të sulmojnë njëri-tjetrin, vetëm atëherë kur të arrihet ekuilibri me trupa dhe armata dhe palët do të

përpiqen të ruajnë "status quo" -në aktuale. "Faktorët që çojnë në fitoren e një lufte, -shkruan Sun Tzu tek "Arti i Luftës", -janë planifikimi, numri i ushtarëve, logjistika, dhe balanca e fuqisë; dhe në fund fituesin e vendos Balanca e Fuqisë". Balanca e fuqisë është politike e një shteti ose grupi shtetesh që mbrohet kundër një kombi ose grupi kombesh të tjera, duke e krahasuar fuqitë mes palëve.

Politikën e ekuilibrit të fuqisë, shtetet mund ta ndjekin e zhvillojnë në dy mënyra:

- a. Duke rritur fuqinë e tyre ushtarake dhe ndjekur garën e armatimit;
- b. Duke i shtuar fuqisë së tyre edhe fuqitë e shteteve të tjera, përmes një politike diplomatike dhe aleancash.

NATO dhe SHBA po afron trupa dhe teknologji ushtarake në vendet anëtare të saj, pikërisht për të vendosur këtë ekuilibër fuqie me ushtrinë ruse të dislokuar në Rusi dhe Bjellorusi, dhe pamundësuar

epërsinë numerike ruse.

Një leksion me përmasa botërore që po rilexojmë këto ditë të ftohta rreth luftës së ftohtë, është "Doktrina e shkatërrimit të sigurt të palëve luftuese", (Mutual assured destruction), e cila, në vitet 60-të pas krizës së raketave ruse bërthamore në Kubë, parandaloi sulmin e sigurt vdekjeprurës nga të dyja palët SHBA-BS. Në kërcënimin aktual, përveç Ruisë edhe Bjellorusia deklaroi se është gati të lejojë armët bërthamore ruse në kufirin dhe territorin e saj. Për balancë parlamenti sllovak, më datë 9 shkurt, vendos të pranojë në territorin e saj trupat dhe armët konvencionale të SHBA-së dhe NATO-s, përfshirë ato bërthamore.

Nëpërmes garës së armatimit dhe të "Deterrence by Presence", midis fuqive kundërshtarë para 60 viteve, u arrit që të ruhej "Balancim i Fuqisë" midis tyre, që kishte të bënte kryesisht me barazimin në numra, në aftësi luftarake dhe lloje armatimit, që dy aleancat përballë dispononin. Sot aktualisht në Kufirin Rusi-Ukrainë po ndodh ngjashmërisht, po synohet të arrihet ky balancim forcash duke rritur personelin ushtarak, armatimin dhe aftësinë luftarake të Kievit për ta barazuar me rusët përballë. Frika e shkatërrimit të ndërsjellë dhe shkuarjes së sigurt në një holokaust bërthamor global u shtua në vitet 60-të nga të dy palët, dhe i bëri ato më të përgjegjshme. Kërcënimi bërthamor injektoi atëherë dhe shpresojmë ta bëjë edhe sot, në politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik, një element të theksuar frike, frenimi dhe përgjegjshmërie. Konfrontimi i drejtpërdrejtë në atë periudhë u zëvendësua kryesisht me frikësim të palëve, nëpërmjet një garë masive armësh, produktet vdekjeprurëse të së cilës nuk u përdorën asnjëherë.

Analistë ushtarakë kur parashikonë një sulm që mund të ndodhë ose jo, marrin në konsideratë ligjësitë dhe faktorët mbi ushtarakët që do ta mundësonin ose shmangnin këtë përballje, ndër të cilat më kryesore janë; a. Raporti i forcave nuk është në favor të Ruisë, pasi 150 000 trupa në mësymje do ndaloheshin

vetëm nga mbi 50 000 ushtarë ukrainas sipas doktrinës së luftës frontale konvencionale;

b. Morali i trupave gati për luftë, është faktor në favor të Ukrainës, pasi luftohet për atdheun e tyre dhe i gjithë populli ukrainas është i motivuar dhe i përfshirë në trajnime për përdorim të armatimit;

c. Aleancat dhe mbështetja ndërkombëtare janë faktorë në favor të Kievit, pasi Rusia ka mbetur e vetme me Kinën abstenuese "pro Ruisë dhe pro paqes", bashkë me aleatët e CSTO: Armenia, Bjellorusia, Kazakistani, Kirgistani dhe



Taxhikistani.

d. "Ushtria marshon mbi stomakun e vet" -na mëson Napolon Bonaparte, dhe e ka fjalën për logjistikën. Logjistika që mbështet luftën është një barrë e rëndë për ekonominë ruse, shtuar kësaj edhe sanksionet e mundshme ndërkombëtare që mund t'i vihen në çdo moment.

e. Befasia, e cila ndoshta edhe qëllimisht, nuk është në favor të Moskës, por po i jep kohë Kievit dhe aleatëve të Ukrainës të përgatisin "varrin rus në Ukrainë".

f. Mbështetja e brendshme është në rënie, pasi opozita ruse është në protestë. Ky është një argument tjetër shtesë në disfavor të Moskës, pasi demonstratat kundër luftës sapo kanë filluar dhe gjasat janë të përshkallëzohen në vartësi të ecurisë së situatës.

Në përmbledhje të këtyre analizave dhe faktorëve, arrihet në përfundim dhe pritsëm që nuk do ketë një luftë konvencionale frontale në Ukrainë, pasi rezultoni të jetë fundi për regjimin dhe veprën e "Vladit

të cmendur". Luftëra të kufizuara asimetrike dhe hibride nuk do të ndalen në këtë rajon dhe nuk do të ndërpriten asnjëherë nga Moska. Lufta me inteligjencë, sajimi i "false flag", sulmeve të brendshme kanë ekzistuar, po ndodhin dhe nuk do ndërpriten për një kohë të gjatë nga rusët, jo vetëm në Ukrainë por në të gjithë perëndimin.

Kërkesat që Moska i bën SHBA-së dhe NATO-s për: largim të NATO-s nga lindja; mos anëtarësim të Ukrainës në aleancë, megjithëse kjo është e drejtë e çdo shteti sovran, të vendosë vetë për fatet e tij; largimin e armatimit konvencional nga vendet kufitare me Ruisë, janë qartësisht të papranueshme dhe kjo dihet edhe nga vetë Putin. Kremli thjesht kërkon të "blejë kohë" dhe të vazhdojë të paraqitet për popullin rus si "mbrojtës së sovranitetit të tokave ruse", dhe të paraqesin "Ukrainën si grabitëse të trojeve ruse". Moska po teston dhe analizon çdo lëvizje të mundshme në mbështetjen ndërkombëtare si dhe atë të brendshme. Në vartësi të këtij "son-

dazhi", që Putin po bën, se çfarë fiton dhe humbet, besohet se do të ndërmerren edhe hapat e tjerë.

NATO jo vetëm nuk i pranoi këto kushte, por i parapriu ato, duke deklaruar se jo vetëm Ukraina por edhe Gjeorgjia dhe shtete të tjera neutrale europiane kanë të drejtë të zgjedhin për t'u anëtarësuar në NATO. Shtetet anëtare të NATO-s pa përjashtim mbështetnin Kievin, dhe janë duke zbatuar një praktikë parandaluese dhe paqësore të "Deterrence by Presence".

Megjithëse Ukraina nuk është anëtare dhe nuk përfiton nga artikulli 5 i NATO-s, pothuaj të gjithë vendet anëtare të saj, veç e veç deri tani, kanë dënuar kërcënimin rus dhe po e mbështesin ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht popullin ukrainas. Situata në dimrin e "ftohtë" e 2021-2022 në kufirin rus-ukrainas, i mbart tiparet e përjetuara në luftën e "ftohtë", me aktorë të vjetër dhe aleanca e reja, por zgjidhja përsëri qëndron si atëherë, tek "racionaliteti" apo "çmenduria" e liderëve.

INTERVISTA **me ish-portierin e Kombëtares shqiptare dhe të skuadrës së Partizanit**

Legjenda e portës shqiptare Perlat Musta

Partizani më dha mbiemrin e madh. Kur erdha fëmijë isha Perlat dhe kur u rrita u bëra Musta.

Intervistoi: Shefe e Sektorit të Botimeve ANJEZA MUSOLLARI

Perlat Musta ka lindur në Vlorë, në vitin 1958. Ish-portier i Kombëtares shqiptare dhe i skuadrës së Partizanit. Legjenda e portës shqiptare ka bërë paraqitje të paharrueshme me Kombëtaren shqiptare, ndër të cilat në mendjet e tifozëve të asaj periudhe janë skalitur ndeshjet spektakolare ndaj Gjermanisë, Polonisë dhe takimi i paharrueshëm ndaj Belgjikës. Ai do të mbahet mend si "portieri" i përrjetshëm i Partizanit, që nuk e tradhtoi asnjëherë klubin edhe në momentet më të vështira.

Musta ka shërbyer për ngjyrat e Partizanit dhe përfaqësueses shqiptare për më shumë se dy dekada. Futet me ekipin e parë të Partizanit më 1976, për ta mbyllur me 1997, Kampion me fanellën e kuqe më 1979, 1981 dhe 1987 dhe fitues i kupës me 1980, 1991 dhe 1997. Njëkohësisht, ai luajti 23 ndeshje me Kombëtaren nga 1981-1993.

Sot, një legjendë e futbollit shqiptar. Por si ka lindur kjo dëshirë?

Duhet të kem qenë rreth moshës 10-vjeçare kur gjithçka rreth meje lidhej vetëm me futbollin, por ndryshe nga shokët e mi që preferonin të luanin në sulm, mua më pëlqente porta. Edhe pse lojën e portierit e kisha vetëm me imagjinatë, sepse kuptohet në vitet 60' mungesa e televizorit ishte në çdo familje shqiptare. Pasi mbarova shkollën në qytetin e lindjes u regjistrova në shkollën e Mjeshtërisë Sportive, por nuk arrita të kapja normat, kështu që nuk u pranova. Për hir të së vërtetës prindërit e mi u gëzuan, sepse nuk kishin dëshirë që unë të merre-

sha me sport, pasi kështu ishte psikologjia e asaj kohe.

Ju ishit pjesë e shkollës "Skënderbej". Si u gjendet aty duke ditur pasionin për futbollin?

Me sugjerimin e prindërve, të cilët i falënderoj, unë fillova shkollën "Skënderbej", e cila do të ishte trampolina ime drejt ëndrrës për t'u marrë me futbollin. Aty gjeta një terren shumë favorizues për të ndjekur pasionin tim, pasi siç dihet në ato vite shkolla "Skënderbej" ishte vendi nga ku dilnin sportistët elitë të të gjitha disiplinave. Pra lidhja ime me klubin e Partizanit duket se u shënjua që në atë vit. Shkolla kishte lidhje të ngushta me klubin e Partizanit, dhe sigurisht që favorizonin elementët që spikasnin. Kështu që aty unë rashë në sy dhe në vitin 1976, kur isha 17 vjeç, u aktivizova me të rinjtë e Partizanit për 1 fazë futbollistike. Më pas kalova tek ekipi i parë në vitin 1979. Atë vit Partizani doli edhe kampion, pas një periudhe të gjatë mungese të trofeut në shtëpinë e kuqe. Që në atë kohë, (me një shkëputje të vogël gjatë kohës kur debutova në Rumani me Dinamon e Bukureshtit) e deri në vitin 1997, unë kam luajtur vetëm për ngjyrat e ekipit të Partizanit."

A mund të na përshkruani rrugën e karrierës suaj?

Unë kam qenë portier i përfaqësueses Shpresa, me të cilën kemi arritur një sukses të madh, siç ishte triumfi në Ballkaniadë. Ne ishim një grup shumë i mirë, që më pas u bashkuam edhe në përfaqësuesen e të rriturve. Unë kam veshur fanellën e kombëtares, më 2 shtator 1981, në një ndeshje ndaj Finlandës, ku bëra një paraqitje të mirë. Më pas kam qenë pjesëtar i kombëtares për shumë vite. Me fanellën kuqezi kam zhvilluar 23 ndeshje ndërkombëtare. Përfaqësuesja



më ka dhuruar shumë emocione, sidomos në ato ndeshje të famshme ndaj Gjermanisë, Polonisë me të cilën barazua 2-2 dhe sigurisht që mbetet e paharruar ndeshja ndaj Belgjikës së Shifos së madh, ku ne fituam 2-0.

Mbresa më ka lënë dhe përballja me Sëlltikun për kupën e kampioneve. U paraqitëm shumë mirë në "Qemal Stafa". Në Britani u vumë nën presionin e skocezëve.

Duhej të vinin eliminatorët e 82-it. Në ekipin kombëtar Jani Kaçi ishte portier i parë. Pas humbjes 5 me 0, largohet Zyber Konçi dhe Loro Boriçi merr drejtimin e kombëtares.

Më 2 shtator debutoj me kombëtaren ndaj Finlandës. Transformohem si titullar i padiskutueshëm deri në vitin 1987.

Çfarë mbani mend nga takimet ndërkombëtare që keni luajtur, cili ju ka lënë më tepër mbresa?

Kam luajtur disa herë me Gjermaninë, skuadër e cila kishte qenë disa herë kampione bote dhe Europe, me lojtarë të mëdhenj si Rumenige, Shumaker etj. Ishte kënaqësi dhe krenari të luaje përballë emrave të tillë, sepse kishte mundësinë të tregojë diçka nga vetja jote. Më pas kanë qenë polakët me Bonjek, austriakët etj. Në 33 ekipe të asaj kohe të Europës, vetëm 7-8 ekipe mund të ishin të nivelit të dobët.

Kombëtarja jonë kishte mundësinë për të arritur në finalet e botërorit. Përse nuk u arrit kjo?

Ishte periudha në eliminatorët e viteve 84-85, në botërorin e Meksikës, ne patëm një moment të mirë të cilin nuk e shfrytëzuam dot për shumë arsye, e para sepse nuk ishim përgatitur psikologjikisht; e dyta, ne shkonim luanim pa bërë asnjëherë një ndeshje miqësore; dhe e treta, në përballje kishim skuadrat e Polonisë dhe Belgjikës të nivelit të lartë. Njëra ishte nën kampione, tjetra doli nën kampione. Patëm dhe një përballje me Greqinë që nuk hynte tek skuadrat e forta, por ne nuk mundëm të merrnim pikë. Shkak ishin disa faktorë, mbase jo dhe teknikë sesa fat, që nuk na mundësuan sjelljen e një trofeu kaq të rëndësishëm në Shqipëri.

Lojtari që ia kishit "frikën" kur i



afrohej portës suaj?

Frikë asnjëherë, respekt kam pasur për të gjithë sulmuesit.

"Me një portier të mirë, në një ekip të dobët mund ta fitosh ndeshjen, ndërsa me një ekip të mirë por me portier të dobët e humbet takimin" (Levi Ashin). A ishte kjo motoja juaj?

Kjo tregon rolin dominant që ka portieri. Padyshim që kjo ka qenë mjaft e rëndësishme për mua, dhe kështu duhet të jetë për të gjithë portierët e skuadrave.

"Partizani i Perlat Sulës apo Perlat Sula i Partizanit?"

Me Partizanin kam fituar 4 kampionate dhe 3 Kupa Republike, çka do të thotë se kam marrë me të vërtetë shumë sadsifaksion. Publiku na ka mbështetur vazhdimisht dhe ende kujtoj me nostalgji shkallët e stadiumeve plot, ku nuk shikoje një vend bosh. Rivaliteti mes skuadrave në ato vite ka qenë realisht shumë i madh dhe niveli i futbollit, bënte që njerëzit të na ndiqnin ngado, ndonëse kushtet ekonomike ishin shumë të disfavorshme. Partizani është familja ime ku u rrita profesionalisht dhe sot së bashku krenohemi për çfarë kemi mundur të arrijmë. Në moshën 17-vjeçare kaloj te ekipi i Partizanit, i cili drejtohej nga emra të njohur, si Refik Resmja dhe Panajot Pano.

Në portë titullar ishte Jani Kaçi, por pas përfundimit të shërbimit ushtarak, ai kthehet në Korçë tek Skënderbeu. U afruan portierë të tjerë, ndërsa unë isha gjithnjë rezerve.

Stërvitesha tre herë në ditë. Ndërkohë më duhej të zgjohesha edhe në 2 të natës nga alarmi i stërvitjes ushtarake. Për sezonin e ri Mikel Janku vendosi veton. Më mbajti në ekip dhe luaj ndeshjen e parë me Partizanin si titullar ndaj Lushnjës, të cilën e fitojmë.

Partizani më dha mbiemrin e madh. Kur erdha fëmijë isha Perlat dhe kur u rrita u bëra Musta.

Cili ka qenë trajneri juaj i parë?

Trajneri im i parë ka qenë Sherif Çiçiku, për të cilin ruaj konsideratat e mija më të mira. Është shumë e rëndësishme të kesh një "mësues" që e dashuron punën e tij, sepse dhe ty si "nxënës" të kalit dëshirën për të arritur majat vetëm me punë. Këtë përpiqem tu them dhe të rinjve tanë sot.

Momenti i kapjes së topit që e kujtoni dhe sot?

Edhe sot e kujtoj, luanim ndaj Benfikës në kupën e Kampioneve, në pjesën e dytë kap një top me planzhon. Lojtari kundërshtar bie mbi mua. Kur ngrihem, gjyqtari më jep karton të verdhë. I buzëqesha me ironi sepse ishte absurditet.

Si u gjendët në skuadrën rumune?

Në fillimin e viteve '90 rrugët ishin hapur. Në këtë kohë erdhi momenti për të provuar vlerat jashtë kufijve të Shqipërisë. Partizani luajti me rumunët e Krajovës në Europë. Drejtuesit filluan të lidhnin kontakte. Ata kërkuan shërbimet e mia. Por nuk bëhem pjesë e Krajovës, sepse Dinamo e Bukureshtit këmbënguli në formën e vet. Mua, Demollarin dhe Arben Mingën na kërkuan të firmosnim me Dinamon. Luajta atje për tre vite.

Perlat Sula si trajner?

Çdo fillim e ka një fund. Në ndeshjen ndaj Tomorit pësoj dëmtim në gju. Ky ishte fundi i karrierës si futbollist, por kurrë jashtë fushës së gjelbër, ajo është oksigjeni im.

Për herë të parë në Shqipëri solla idenë e trajnerit të portierëve, koncept që nuk ekzistonte më parë. Ishim mësuar që trajneri i parë të stërviste të gjithë skuadrën së bashku. Stërvita shumë portierë duke ndjekur gjithnjë një parim.

“Trajneri i mirë është ai që tregon rrugën e drejtë dhe portieri i mirë është ai që kupton rrugën dhe korrigjohet.”

Jo me të gjithë portierët ka funksionuar kjo teori, por me një pjesë ka dhënë rezultate shumë të mira. Selmani ishte vetëm 5



vjeç kur e stërvita. Kishte talent që në atë moshë. Sot Selmani është portieri më i kompletuar në kombëtaren shqiptare. Për mua ai duhet të jetë titullari i portës.

Çfarë profesioni do të zgjidhni nëse nuk do të ishit futbollist?

Ky është pasioni dhe profesioni që kam ëndërruar prej fëmijërisë së largët. Dola kundër prindërve sepse e doja, dhe nëse diçka e do fort dhe përpiqesh ta ushqesh me dashurinë e duhur, nuk ka forcë që e ndal.

Kuriozitet kemi për golin që ju i dhuroat kinezëve? Si ndodhi?

Ka qenë një episod mjaft inte-

resant, kur pata rastin të mbroj portën e ekipit të të rinjve të Partizanit, në një ndeshje me një ekip kinez, në kuadër të “miqësisë” mes dy vendeve që ekzistonte në atë kohë. Në pjesën e parë ne kryesonim me rezultatin e thellë 5-0. Në pushim të ndeshjes, na u tha që duhet të tregoheshim më “bujarë” me miqtë dhe “nderi” më takonte mua, meqenëse unë do të isha portier në pjesën e dytë. Si përfundim, kinezët mundën të shënonin 2 gola, ndërkohë që pas disa kohësh, miqtë më thanë se ata gola të pësuar u panë nga “specialistët” si një dobësi e imja. E ku ta dinin ata se ne ua dhuruam haptazi golat!

Futboli dje dhe sot? Si ju duket të rinjtë tanë në fushën e gjelbër?

Dikur futboli luhej jo vetëm me këmbë, por me shpirt dhe mendje. Pra gjithçka behej duke kalkuluar situatën që kishe përpara. Sot i përdorin këmbët por jo ndjesitë. Por të rinj të talentuar kemi dhe me punën e tyre unë besoj se e ardhmja do jetë dhe më e ndritur

Në fillesat tona gjithmonë kemi nevojë për dikë që të na mbështesë dhe për të cilin jemi falënderues në gjithë ciklin e jetës. Po ju kujt ia adresoni falënderimet tuaja?

I jam mirënjohës dhe falënderues klubit të madh Partizani për gjithçka që më ka dhënë.



Jens Stoltenberg:

Nuk ka vend për llogaritje të gabuara në lidhje me aftësinë tonë për të mbrojtur të gjithë aleatët

Menjëherë pas përfundimit të takimit të jashtëzakonshëm të Komisionit të NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm ka dhënë një deklaratë për shtyp në lidhje me situatën e jashtëzakonshme në Ukrainë, ku i është përgjigjur pyetjeve të medive të ndryshme ndërkombëtare.

Duke qenë se NATO ka politikë mjaft transparente në vlerësimin e situatës, a mund të ndani vizionin? A keni diskutuar me palën ukrainase mundësinë që trupat ruse të mos ndalojnë në vijën e kontaktit dhe ne do të shkojmë më thellë, të paktën në kufijtë administrativë të zonave të Luhanskut dhe Donjeckut? Dhe cili do të jetë reagimi i NATO-s në këtë drejtim? Cili është vlerësimi juaj? Sa i lartë është ende rreziku i një operacioni të flamurit të rremë nga pala ruse?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg: Çdo tregues është se Rusia vazhdon të planifikojë një sulm në shkallë të plotë ndaj Ukrainës. Ne shohim ngritjen e vazhdueshme ushtarake. Ata premtuan të tërhiqen,

Intervistë e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, pas një takimi të jashtëzakonshëm të Komisionit NATO-Ukrainë

por ndërkohë ata kishin vazhduar të rriteshin. Shohim që gjithnjë e më shumë forca po largohen nga kampet dhe janë në formacione luftarake dhe gati për të goditur. Dhe ne shohim provokimet e vazhdueshme në Donbass dhe operacionet e ndryshme të flamurit fals ku ata përpiqen të krijojnë një pretekst për një sulm.

Ne pamë mbrëmë se trupat e mëtejshme ruse u zhvendosën në Donbass, në pjesë të Donetsk dhe Luhansk. Dhe më pas, kemi retorikën kërcënuese e cila në fakt u konfirmua në fjalimin e djeshëm të Presidentit Putin.

Në të njëjtën kohë, nuk është kurrë vonë. Nuk është kurrë vonë për të mos sulmuar. Dhe kjo është arsyeja pse ne vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Rosisë që të tërhiqet, të



de-përshkallëzohet dhe të angazhohet me mirëbesim në përpjekjet diplomatike për të gjetur një zgjidhje politike.

Nëse Rusia vendos, edhe një herë, të përdorë forcën kundër Ukrainës, do të ketë sanksione edhe më të forta, madje edhe një çmim më të lartë për të



paguar. Aleatët vazhduan të ofrojnë mbështetje për Ukrainën. Dhe në takimin me Ukrainën sot, shumë aleatë u zotuan të vazhdojnë mbështetjen, mbështetjen financiare, mbështetjen ushtarake, dhe gjithashtu NATO ofron mbështetje kritike për të ndihmuar Ukrainën të forcojë mbrojtjen e saj kibernetike.

Dhe sigurisht, përgjegjësia kryesore e NATO-s është të sigurohet që të mos ketë agresion kundër ndonjë vendi aleat të NATO-s. Pra, ne kemi rritur tashmë praninë tonë në pjesën lindore të Aleancës. Dhe ne jemi gati të rrisim më tej praninë tonë në pjesën lindore të Aleancës, nëse është e

nevojshme.

Ju thoni: Natën e kaluar, trupat të tjera ruse hynë në Donbass. A keni prova që trupat, automjetet, njerëzit, pajisjet ruse kanë lëvizur nga territori rus në territor ukrainas, konkretisht, a keni prova që trupat e reja ruse kanë lëvizur nga Rusia në Donbass, që është territori i pushtuar i Ukrainës? Dhe nëse po, ky është një pushtim, apo jo? Dhe nëse po, a keni ndryshuar fare qëndrimin tuaj?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Po. Dhe unë mendoj se, përsëri, ne duhet të kuptojmë se Rusia ka qenë në Donbass për shumë vite që nga viti 2014. Por kjo ka qenë në një operacion të fshehtë ku ata kanë mohuar praninë e tyre. Por të ashtuquajturit separatistë janë kontrolluar dhe mbështetur nga trupat ruse, personeli i operacionit special rus për shumë e shumë vite. Pra, Rusia ka qenë e pranishme në operacione të ndryshme të fshehta në Donetsk dhe Luhansk për shumë e shumë vite. Ajo që ne shohim tani është forca dhe trupa shtesë ruse që hyjnë brenda. Dhe kjo e bën të gjithë situatën edhe më serioze. Dhe më pas, kjo kombinohet me njohjen e këtyre territoreve, të cilat janë brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht të Ukrainës, si shtete të pavarura. Pra, kjo "i shton benzinë zjarrit". Kjo po e bën atë më të rrezikshëm dhe më serioz. Dhe pastaj, në krye të kësaj, ne shohim gjithashtu ngritje të vazhdueshme ushtarake ruse dhe përgatitje për një sulm në shkallë më të gjerë në Ukrainë.

A mund të na jepni një pamje të saktë mbi forcat dhe mjetet ushtarake që janë vendosur nga Rusia pranë kufirit dhe në Donbass dhe forcat nga separatistët? Ju keni folur për 150,000 trupa, por për të qenë më të saktë?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Epo, ajo që mund të them është se Rusia ka mbi 150,000 trupa. Përveç kësaj, natyrisht, ka forca ajrore dhe forca detare gjithashtu afër Ukrainës. Dhe

këto forca janë pjesërisht brenda Ukrainës tashmë, në Krime dhe në Donbas, dhe pjesërisht afër kufijve të Ukrainës, si në lindje, por edhe në jug, dhe gjithashtu në veri, pjesërisht në Rusi dhe pjesërisht në Bjellorusi.

Dhe këto forca janë gati luftarake, dhjetëra mijëra trupa luftarake. Por edhe të gjitha llojet e mundësuesve: raketa, mjete të blinduara, tanke luftarake, drone, sisteme për luftë elektronike, mbrojtje ajrore, raketa Iskander, të cilat në fakt janë raketa me aftësi të dyfishta dhe një gamë e gjerë aftësish të ndryshme ushtarake. Pra, kjo është një forcë e cila jo vetëm që është e fortë, e pajisur mirë, dhe ka shumë aftësi të nivelit të lartë, por është gjithashtu forcë e cila tani është plotësisht e pajisur me municion dhe karburant. Dhe më pas, gjithnjë e më shumë trupa janë larguar nga kampet e tyre dhe tani janë në një pozicion ku mund të sulmojnë pa asnjë kohë paralajmërimi.

Pra, sigurisht, kjo e bën të gjithë situatën shumë të rrezikshme. Por, siç e kemi thënë përsëri dhe përsëri, Rusia ka ende zgjedhjen për të zgjedhur diplomacinë, për t'u tërhequr dhe për t'u përfshirë në një dialog politik me aleatët e NATO-s. Dhe ne kemi treguar gjatë një periudhe të gjatë kohore se jemi gati të ulemi, të bisedojmë me Rusinë në mirëbesim për çështje që kanë rëndësi edhe për sigurinë e tyre: kontrolli i armëve, transparenca dhe më pas çështjet e tjera.

A shqetësoheni se Rusia po deklaroi se do ta njohë këtë sovranitet edhe mbi pjesë të Ukrainës që aktualisht kontrollohen nga forcat ukrainase? Kjo duket se do ta bënte shumë më të lartë probabilitetin e konfliktit. Dhe me shtetet baltike, dhe aleatët e tjerë fqinjë, që bëjnë thirrje për më shumë mbështetje, madje edhe më shumë se sa ka bërë NATO deri më tani. Çfarë mund të bëni më shumë në të ardhmen shumë të afërt, në ditët në

vijim, për të qetësuar ata aleatë nervozë?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Ajo që kemi parë është pak sinjale të përziara nga Moska nëse ata kanë njohur territorin midis kufirit rus dhe linjës së kontaktit, apo kanë njohur si "Republikat Popullore të Donetskut dhe Luhanskut", të gjithë territorin e dy rajoneve.

Por gjithsesi, ky është një ndryshim hapi. Kjo po shton më tej kërcënimet dhe cenimin e integritetit territorial dhe sovranitetit të Ukrainës, vetëm fakti që i kanë njohur këto entitete si shtete të pavarura.

Dhe kjo është arsyeja pse ne e dënojmë atë kaq qartë. Dhe gjithashtu arsyeja pse ne mirëpresim sanksionet që aleatët e NATO-s sot, në formate të ndryshme, kanë vendosur të vendosin. Dhe gjithashtu pse e mirëpresim vendimin e Gjermanisë për të ndaluar miratimin e projektit "Nord Stream 2".

Tashmë kemi rritur praninë tonë në shtetet baltike. Ne e bëmë këtë pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë në 2014. Dhe e kemi bërë gjithashtu gjatë javëve dhe muajve të fundit.

Pastaj, ne kemi plane në vend. Ne kemi forca në dispozicion për të përforcuar më tej, nëse është e nevojshme. Ne do ta bëjmë këtë në një mënyrë mbrojtëse. Qëllimi ynë është të parandalojmë konfliktin, është të sigurojmë aleatët. Dhe sigurisht, përgjegjësia kryesore e NATO-s është të sigurohet se nuk ka vend për ndonjë llogaritje të gabuar në lidhje me angazhimin tonë për t'u mbrojtur dhe mbrojtur aleatët. Dhe me këtë gjithashtu parandaloni çdo sulm ndaj çdo vendi aleat.

A është aktivizuar Forca e Reagimit të NATO-s? Nëse po, sa trupa po vendosen në Evropë?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Forca e Reagimit të NATO-s është vënë në gatishmëri më të lartë. Ne e bëmë këtë disa javë më parë. Por nuk është vendosur.

Ajo që ne kemi dislokuar janë

njësi të tjera nga vendet aleate të NATO-s. Shtetet e Bashkuara kanë dislokuar trupa dhe forca në Europë. Disa prej tyre i kam takuar në Rumani para disa ditësh. Gjermania ka dislokuar më shumë trupa në Lituani. Mbretëria e Bashkuar ka dyfishuar praninë e saj në Estoni me grupin e betejës atje. Dhe aleatë të tjerë duke përfshirë Spanjën, Holandën, Danimarkën dhe shumë të tjerë kanë vendosur të dërgojnë trupa, anije dhe avionë për të përforcuar praninë tonë. Dhe Franca e ka bërë gjithashtu të qartë se ata janë gati të udhëheqin një grup betejë në Rumani. Pra, deri më tani kemi rritur gatishmërinë e Forcës së Reagimit të NATO-s, por nuk e kemi dislokuar Forcën e Reagimit të NATO-s.

Putin u kërkoi ligjvënësve leje për të përdorur forcën jashtë Rosisë, kjo mund të hapë rrugën për një sulm më të gjerë ndaj Ukrainës. Si do ta komentoni këtë çështje? Dhe gjithashtu dje Putin foli shumë për zgjerimin e NATO-s. Dhe ju e dini se me Ukrainën, Gjeorgjia po pret gjithashtu anëtarësimin e ardhshëm dhe deklarata të tilla janë kaq shqetësuese për ne. Cili është komenti juaj? Dhe a është e mundur dhe e pranueshme ajo që Putin po fliste dy ditë më parë, i ashtuquajturin moratorium për zgjerimin e NATO-s?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Një kërkesë për të marrë leje për të përdorur forcën jashtë territorit rus thjesht shton modelin e vendimeve dhe veprimeve të Rosisë gjatë muajve të fundit, gjë që ka çuar në momentin më të rrezikshëm për sigurinë tonë në dekada. Dhe ky është vetëm një hap tjetër.

Mendoj se duhej të kujtonim se, në fakt, NATO dhe Aleatët e NATO-s paralajmëruan këtë vjeshtë se ne pamë një ngritje ushtarake nga Rusia dhe plane për të arritur një nivel të forcave ruse në dhe rreth Ukrainës, që është shumë këtu ku jemi sot. Pra, kjo është diçka që është parashikuar shumë muaj më parë. Dhe më pas, Rusia ka bërë atë që prisnim dhe atë



që paralajmëruam. Ata kanë rritur ndjeshëm praninë e tyre ushtarake në dhe rreth Ukrainës. Dhe më pas të kombinuara me retorikën dhe të gjitha operacionet e flamurit të rremë, përpjekjet për të krijuar një pretekst. Dhe tani, njohja e "Republikave Popullore të Donetskut dhe Luhanskut", e gjithë kjo i shtohet këtij modeli të sjelljes kërcënuese dhe agresive. Dhe çdo leje për të përdorur forcën jashtë territorit rus thjesht e shton atë model.

Kjo në thelb nuk e ndryshon mesazhin tonë. Dhe kjo është se ne vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Rusisë të tërhiqet, të mos vazhdojë të rritet, siç e kemi parë gjatë javëve të fundit. Por edhe që angazhohen në përpjekje të vërteta diplomatike.

NATO e ka bërë të qartë se ne jemi gati të bisedojmë. Dhe ne kemi renditur me letra ose në letrën që i kemi dërguar Rusisë, por edhe Shtetet e Bashkuara i kanë përcjellë Rusisë një dokument paralelisht me NATO-n, ku renditim shumë fusha që ishim gati të uleshim, të diskutonim dhe të përpiqeshim të gjenim një rrugën politike përpara.

Por në atë dokument, ne gjithashtu e kemi bërë të qartë se nuk do të bëjmë kompromis për vlerat thelbësore. Dhe njëra prej tyre është sigurisht e drejta që çdo kombi të zgjedhë rrugën e vet. Zgjerimi i NATO-s ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm për Europën

gjatë shumë dekadave. Ajo ka ndihmuar në përhapjen e demokracisë, lirisë në të gjithë Europën për dekada pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Dhe ne nuk do të komprometojmë të drejtën tonë për t'u mbrojtur dhe mbrojtur të gjithë aleatët, kur Rusia kërkon që ne të nënshkruajmë një marrëveshje ligjërish të detyrueshme për të hequr të gjithë infrastrukturën e NATO-s, të gjitha forcat e NATO-s nga territoret e atyre aleatëve që u bashkuan me Aleancën pas 1997. Ne nuk mundemi pranoheni këtë. Sepse kjo do të jetë njësoj si të thuash se ne do të prezantojmë një lloj anëtarësimi të klasit të parë dhe të dytë në NATO, ku nuk kemi të njëjtën të drejtë për të mbrojtur ata aleatë që u bashkuan pas 1997.

Pra, ne nuk do të bëjmë kompromis për këto parime. Por ne jemi të gatshëm të angazhohemi në dialog politik për shumë çështje të rëndësishme, të cilat janë gjithashtu të rëndësishme për sigurinë e Rusisë.

Njerëzit në mbarë botën, dhe veçanërisht në Europë, tani kanë frikë nga një luftë e plotë. Çfarë mendoni për atë frikë? Dhe sa larg jemi?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Ekziston një rrezik real. Dhe pikërisht kjo është arsyeja pse ne

kemi paralajmëruar kundër kësaj për muaj të tërë. Dhe për fat të keq, ajo që kemi parë gjatë muajve të fundit është se ka ndodhur pikërisht ajo që kemi parashikuar. Por është ende e mundur që Rusia të ndryshojë kursin dhe të mos vazhdojë ngritjen ushtarake dhe të mos pushtojë më tej Ukrainën.

Unë mendoj gjithashtu se ne duhet të kuptojmë se Ukraina është një partner shumë i vlerësuar. Ne i mbështesim me mbështetje ushtarake, me mbështetje politike, me mbrojtje kibernetike, me pajisje. Aleatë të ndryshëm ofrojnë lloje të ndryshme mbështetjeje.

Por kur bëhet fjalë për aleatët e NATO-s, ne ofrojmë garanci absolute sigurie. Do të thotë se ne e bëjmë absolutisht të qartë se një sulm ndaj një aleati do të shkaktojë një përgjigje nga e gjithë Aleanca. "Një për të gjithë. Të gjithë-për një". Dhe kjo është gjithashtu arsyeja pse NATO ka rritur praninë e saj në pjesën lindore të Aleancës, në një mënyrë mbrojtëse, për t'u siguruar që nuk ka vend për llogaritje të gabuara në lidhje me aftësinë tonë për të mbrojtur të gjithë aleatët. Dhe për sa kohë që ne e bëjmë këtë, ne do të parandalojmë një sulm ndaj vendeve aleate të NATO-s.



Themelimi i policisë ushtarake të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), po shihet si një hap i madh drejt anëtarësimit të Kosovës në NATO.

Shefi i komunikimit strategjik në Ministrinë e Mbrojtjes, kolonel Sefer Isufi deklaroi se me Projektligjin për ushtrinë e FSK-së dëshmohet se Kosova është duke shkuar rrugës së duhur për t'u anëtarësuar në NATO: "Projektligji për policinë ushtarake është i rëndësishëm sepse kjo dëshmon se FSK po krijon komponentët e saj, strukturat e saj funksionale dhe operacionale në përputhje me praktikat më bashkëkohore që i kanë edhe ushtritë e vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s".

Në seancën e radhës në Kuvendin e Kosovës, 61 deputetë të pozitës dhe opozitës votuan në parim pro Projektligjit për policinë ushtarake.

Ky Projektligj, siç thekson Isufi, ka për qëllim të "rregullojë dhe përcaktojë misionin, organizimin, autorizimet dhe detyrat e policisë ushtarake".

Zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes sqaron se policia ushtarake ka autoritet dhe është e ngarkuar që të kujdeset edhe në taks-forcat e FSK-së të cilat angazohen në operacione jashtë



Kosova është në rrugën e duhur Ministria e Mbrojtjes: Projektligji për Policinë Ushtarake, një hap para për anëtarësim në NATO

vendit. "Ekskluzivisht detyra e saj është të monitorojë, mbikëqyrë dhe të kontrollojë zbatimin e ligjit në kuadër të autoritetit të FSK-së. E ka për obligim mbrojtjen e FSK-së gjatë shërbimit, stërvitjeve por edhe gjatë operacioneve të saj. E ka edhe për obligim të mbrojë dhe ruajë burimet njerëzore, materiale, teknologjike, sistemet ushtarake, sistemet e mbrojtjes".

"Policia Ushtarake vepron brenda dhe jashtë kazermave të FSK-së. Është e autorizuar ta ushtrojë autoritetin e saj ndaj pjesëtarëve të uniformuar të FSK-së dhe punon-

jesve civilë të Ministrisë së Mbrojtjes. Gjithashtu, ka autoritet të mbikëqyrë rendin publik por edhe rendin gjatë operacioneve të FSK-së brenda perimetrit ku zhvillohet ai", -thekson Isufi.

Rrugëtimi i Kosovës për anëtarësim në NATO

Kosova aplikoi për t'u bërë pjesë e Partneritetit për Paqe në vitin 2012, katër vjet pasi shpalli pavarësinë e saj nga Serbia dhe të njëjtin vit që përfundoi edhe mbikëqyrja e Kombeve të Bashkuara mbi Kosovën.

Në vitin 2016, qeveria e



PRESIDENTJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
VJOSA OSMANI, KA REAGUAR PAS
SULMEVE TË RUSISË NDAJ UKRAINËS

Presidentja Osmani: Qëndrojmë me popullin ukrainas - hegjemonia ruse do të dështojë sërish

“Në ditë si kjo, kur shohim horrorin e luftës me të cilin përballlet ky shtet, qëndrojmë me popullin ukrainas dhe shprehim solidaritetin tonë të thellë. Imazhet e tmerrshme nga Ukraina na përkujtojnë sërish rëndësinë e aleancave mes popujve demokratikë, si e vetmja mënyrë për t’i dalë

ballë hegjemonisë së Rusisë dhe të satelitëve të saj”, -ka thënë presidentja Osmani.

Lufta në Ukrainë, si rezultat i akteve të agresionit dhe sulmeve të paporvokuara të Rusisë, na e përkujton se sa e vlefshme është liria. Në ditë si kjo, kur shohim horrorin e luftës me të cilin përballlet ky shtet, qëndrojmë me popullin ukrainas dhe shprehim solidaritetin tonë të thellë. Imazhet e tmerrshme nga Ukraina na përkujtojnë sërish rëndësinë e aleancave mes popujve demokratik,

si e vetmja mënyrë për t’i dalë ballë hegjemonisë së Rusisë dhe të satelitëve të saj. Prandaj, jemi në koordinim të vazhdueshëm me aleatët tanë, për të mos lejuar destabilizimin e rajonit tonë. Hegjemonia ruse do të dështojë sërish. Liria dhe demokracia do të triumfojnë!

Kosovës bëri përpjekje për të forcuar bashkëpunimin e saj me NATO-n, por ishte Spanja ajo që doli shprehimisht kundër saj. Në vitin 2017, megjithatë, NATO pranoi ta forcojë bashkëpunimin e saj me Kosovën, por vetëm midis forcës paqeruajtëse të KFOR-it dhe zyrës ndërlidhëse dhe ekipit këshillues të NATO-s në Prishtinë.

NATO ka një prezencë të forcave paqeruajtëse, KFOR, në Kosovë që nga përfundimi i luftës në vitin 1999. Mirëpo, janë katër shtete anëtare të NATO-s të cilat nuk e kanë njohur Kosovën si të pavarur – Spanja, Rumania, Sllovakia dhe Greqia. Për sa kohë këto vende nuk e bëjnë një gjë të tillë, nuk do të jetë e mundur që Kosova të anëtarësohet në NATO ose të futet në një marrëveshje për të bashkëpunuar me aleancën përmes programit të saj të Partneritetit për Paqe. Kjo pasi, neni 5 i traktatit themeltar të NATO-s ruan parimin e mbrojtjes kolektive – “një sulm kundër një aleati konsiderohet si një sulm kundër të gjithë aleatëve”.





Ministria e Mbrojtjes përcjell me vëmendje maksimale zhvillimet e fundit dhe veprimet aktuale të Rusisë kundër Ukrainës, vendeve të krahut lindor të NATO-s, si dhe aktivitetet hibride që Rusia zhvillon në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Aktivitetet e luftës hibride, në rajonin tonë, Rusia përmes Serbisë, i realizon në vazhdimësi me luftën politike me metoda jokonvencionale destabilizuese të ndërthurura me aktivitete asimetrike siç janë sulmet kibernetike dhe ato përmes lajmeve të rreme (fake news).

Prandaj, kërkojmë vëmendje të shtuar të autoriteteve politike dhe ushtarake të NATO-s përmes Komandës së Forcës së Bashkuar në Napoli (JFCNP) në rajonin tonë, për të pamundësuar kështu ndikimin dhe influencën e qarqeve destabilizuese ruso-serbe të mbështetura edhe nga qarqet kineze në rajon. Zhvillimet e shpeshta në kufirin Kosovë-Serbi dhe provokimet nga ushtria serbe, i vlerësojmë kërcënim shumë serioz dhe duhet të adresohen fuqishëm politikisht nga Bashkimi Europian dhe me veprime e qëndrime konkrete nga NATO, respektivisht Komanda e Forcës së Bashkuar në Napoli (JFCNP) përmes operacionit KFOR në Kosovë. Republika e Kosovës qëndron fuqishëm përkrah NATO-s të udhëhequr nga SHBA, në interes të mbrojtjes së vlerave euroatlantike dhe në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal, kontinental dhe global.



Republika e Kosovës qëndron fuqishëm përkrah NATO-s në krizën mes Ukrainës dhe Rusisë



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari takim me oficeret e dalluara të FSK-së; u pritën edhe nga Presidentja Osmani

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari priti në takim togër Liridona Baftjari - Jasharin, nëntoger Jeta Berishën dhe nëntoger Arbenita Haxholli - Grezdën, të cilat kanë treguar performancë të jashtëzakonshme gjatë kryerjes së kurseve të karrierës në akademitë e shteteve partnere.

Toger Liridona Baftjari - Jashari është oficer i fushës së komunikimit dhe ka përfunduar Kursin e Oficerit Shtabor në Institutin e Luftës Tokësore në Turqi. Për performancën e shkëlqyer gjatë këtij kursi Toger Baftjari u vlerësua si oficeri më i mirë ndërkombëtar.

Nëntoger Jeta Berisha është gjithashtu oficer i fushës së komunikimit dhe ka përfunduar Kursin Bazik të Oficerit për Sinjale në SHBA. Gjatë këtij kursi Nëntoger Berisha u dallua në përvetësimin e planit mësimor dhe u shpërblye me çmimin "Dexter Award", që jepet për oficerin e dalluar



ndërkombëtar.

Nëntoger Arbenita Haxholli - Grezda është oficer i fushës së logjistikës dhe ka përfunduar Kursin Bazik të Oficerit për Logjistikë, në Universitetin Ushtarak për Logjistikë në SHBA. Nëntoger Haxholli - Grezda gjithashtu u diplomua në këtë kurs si studente e dalluar ndërkombëtare. Me këtë rast, Gjeneral Jashari, para oficerëve u shpreh se, ndihet krenar me arritjet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe falënderoi oficeret për përfaqësimin dinjitoz të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Po

sot, Gjeneral Jashari së bashku me oficeret u pritën në takim nga Presidentja e Republikës së Kosovës, njëkohësisht Komandantja Supreme e FSK-së, znj. Vjosa Osmani, me këtë rast e njoftoi me arritjet e tyre.

Me këtë rast, Presidentja Osmani theksoi se arritjet e oficerëve tona janë pasqyra më e mirë e profesionalizmit dhe mundësie të barabarta në FSK. Kurse, Gjeneral Jashari shprehu bindjen e thellë që këto arritje do të inkurajojnë edhe më shumë gratë dhe vajzat e reja që të bashkohen në shërbim të atdheut.

Gjeneral Jashari, priti në takim ekipin e ekspertëve amerikanë të Institutit për Qeverisje të Sigurisë

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari priti sot ekspertët amerikanë të Institutit për Qeverisje të Sigurisë (Institute for Security Governance) të kryesuar nga z. Keith Dunn. Me këtë rast, Gjeneral Jashari shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për kontributin e ISG-së për mbështetjen në procesin zhvillimor dhe

reformues të FSK-së. Ai gjithashtu shprehu falënderimin e thellë për SHBA-në për gjithë mbështetjen e pazëvendësueshme në të gjitha të arriturat e dërritashme dhe vizionin tonë për të ardhmen. Nga ana e tij, z. Dunn uroi gjeneral Jasharin për detyrën e re duke shprehur besimin e plotë se procesi i tran-

zicionit të FSK-së do të vazhdojë të realizohet suksesshëm në përputhje me synimet e tij.

ISG ka mbështetur dhe vazhdon të mbështes liderhipin e Ministrinë së Mbrojtjes dhe FSK-në gjatë procesit përgatitor për tranzicion nga mandati i kaluar në mandatin ushtarak të saj.



Ministrja Petrovska në takim me ambasadorin e BE-së Gir

“Do të punojmë së bashku për rezistencë ndaj kërcënimeve hibride”

Maqedonia e Veriut jep kontributin e saj të padyshimtë për sigurinë europiane dhe rajonale, si dhe në politikën e përbashkët të mbrojtjes dhe sigurisë së Unionit. Pjesëtarët e Armatës janë pjesë e misionit të BE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, ALTHEA, si dhe misionit të Unionit në Republikën e Afrikës Qendrore. Vendi është pjesë e Europës, jeton me vlerat europiane dhe respekton parimet europiane, ndaj duhet të ndërmerret hapi tjetër: fillimi i negociatave për anëtarësim në BE. Hapja e negociatave është një sfidë që do të ndikojë pozitivisht në avancimin e proceseve në vend. Këtë e deklaroi ministrja e Mbrojtjes, Sllavjanka Petrovska në takimin e sotëm me ambasadorin e BE-së, Dejvid Gir. “Integrimi i Maqedonisë së Veriut dhe Ballkanit Perëndimor në BE është një qëllim gjeostrategjik dhe një interes politik, i sigurisë dhe ekonomik si për rajonin ashtu edhe për Unionin. E vlerësojmë mbështetjen tuaj dhe jemi të gatshëm për fillimin e negociatave”, -tha ministrja Petrovska. Ministrja Petrovska dhe ambasadori i BE-së Gir u pajtuan se BE-ja dhe Maqedonia e Veriut e njohin njëllaj rëndësinë e çështjeve të rezistencës ndaj kërcënimeve hibride, infrastrukturës kritike dhe mbrojtjes civile dhe se do të thellojnë bashkëpunimin në këto fusha. Ambasadori i BE-së Gir mirëpriti planet e Ministrisë për të rritur Qendrën e NATO-s në Maqedoni, Qendrën Rajonale të Marrëdhënieve me Publikun, në një Qendër për Marrëdhënie me Publikun dhe Menaxhimin e Dezinformimit.



Petrovska takohet me ambasadorin spanjoll, Garsia: përkushtim për thellimin e bashkëpunimit në mbrojtje mes dy vendeve

